

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.3/4, Mars - Prill 2015

PASHKA NË KRYEDIOQEZËN E SHKODRËS

Java e Madhe- Java e Pashkës

(1-5 prill 2015)

Pashka, si një ngjarje shumë e rëndësishme në jetën kishtare edhe këtë vit u kremtua me një varg ceremonish që u zhvilluan në Katedralen e Shkodrës. Java se Madhe, siç njihet në kalendarin liturgjik, nisi të Enjte e Madhe, më Meshë në orët para ditës, ku u shuguruan Vajrat për ndarjen e Sakramentëve të Shenjta. Në orët e mbrëmjes u zhvillua Mesha e Darkës së Fundit të Jezui Krishtit, Kjo Meshë është dhe përkujtim i themelimit të Eukaristinë Shenjtë - Meshës, nga vet Jezusi. Gjatë kësaj Meshës u zhvillua dhe riti i larjes së këmbëve simbol i një përvujtërie dhe shërbimi ndaj grigjës së besuar nga Zoti. Po kështu të Premten me ritet përkatëse u përkujtua gjykimi dhe vdekja e Jezui Krishtit. Ceremonia kulmore e festes së Pashkës, ishte kremtimi Meshës së Shtunë në orët e mbrëmjes, ku është zhvilluar një ceremoni e gjatë, por shumë domethënëse. Gjatë kësaj Meshe, pos bekimit të zjarrit, ndezjes së Qiriut të Pashkës, spikaste pagëzimi i 12- të rriturve të cilët me këtë gjest treguan vendosmëri për ta ndjekur rrugën e Krishtit të Ngjallur. E diela dita e Ngjalljes së Krishtit pas meshës u shoqëruar me urime të ndërsjella, duke kumtuar njeri tjetrit lajmin për Ngjalljen e Krishtit. Ceremonitë e Javës së Madhe, qenë udhëhequr nga Kryepeshkvi i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra, shoqëruar nga famullitari i Shkodrës, Dom Artur Jaku.





Radio Vatikani PASHKËT	4
Don Nosh Gjollaj MIRËNJOHJA E TË DREJTËS MARTEORE	7
Don Prend Kola FJALORTH LITURGJIK	11
Lorenzo Rossetti NATYRA DHE MISIONI I KISHËS	13
Don Lush Gjergji AT EMANUELE GIORDANO	16
Ndriçim Kulla AT ZEF VALENTINI	18
Prof. Vinçenc Gjini DR. DON. GASPËR GJINI	21
Iliriana Koleka KONGRESI I MANASTIRIT	23
Arben Llalla SHËN ALBANI	27
Lazër Stani SELIA APOSTOLIKE DHE SHQIPTARËT	29
Redaksia PRESIDENTI NISHANI NË TIVAR	31
VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 3/4 (474-475) Mars - Prill 2015

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
nike.ukgjini@gmail.com
Web page: kishakatolikeshkoder.com
Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PASHKËT**Krishti u Ngjall! Me të vërtetë u Ngjall, Aleluja!**

Të Shtunën e Madhe ndalemi te liturgjia e Natës së Shenjtë të Ngjalljes së Jezu Krishtit, Natës së Pashkëve në të cilën Kisha mbarë i kumton njerëzimit Ngjalljen e Krishtit. Kjo e vërtetë e fesë së krishterë është pika kulmore e tërë Vitit të Liturgjisë Kishtare dhe thelbi i fesë sonë të krishterë, e për këtë arsye solemniteti i Pashkëve quhet me të drejtë festa e të gjitha festave, e kjo Natë tejet e Shenjtë e Pashkëve, 'nëna e të gjitha netëve, nëna e të gjitha festave' të krishtera. Në këtë Natë të Shenjtë, gjithçka përkon, gjithçka përmbledhet e merr kuptim të ri në Dritën Shpëtimprurëse të Jezusit të Ringjallur.

Pra, në këtë Natë të Shenjtë të Ngjalljes së Jezu Krishtit, kremtojmë ngjarjen e madhe e vendimtare që ia ndryshoi rrjedhën historisë së njerëzimit: kremtojmë fitoren e Krishti mbi vdekjen e këndeje me Krishtin e në Krishtin edhe ngadhënjimin e njerëzimit mbi të keqen e vdekjen.

Në këtë Natë të Shenjtë të Pashkëve "kumtojmë fenë tonë në Krishtin e kryqëzuar, të vdekur e të ringjallur. Kumtojmë shpresën tonë në njerëzimin e shëlbuar e të bërë "bir" të Zotit. Shpallim sot dashurinë që na shpëtoi e që bëri të lindë në ne dashuria". Prania në Eukaristi, nata e lutjes në Gjetseman, falja e armiqve, feja në Krishtin, të Birin e njeriut, përcaktimi mes të mirës e së keqes që çdo njeri duhet të bëjë me përgjegjësi të

ndërgjegjes së vet, kryqi i Krishtit, shenjë e dashurisë dhe e lavdërimit: në këtë vështrim duhet t'i përshkojmë orët e mbrëmjes së Jezusit, jo si një përkujtim thjesht të një riti fetar, por të një afërsie të besimit e të liturgjisë pashkvore në dashurinë Ngadhënjimtare të Zotit të Jetës.

Vigjilja e Pashkëve përmban këto katër pjesë:

E Shtuna e Madhe e Pashkëve është ditë kundrimi dhe heshtjeje të madhe, ditë të cilën të krishterët ftohen ta kalojnë në lutje deri në kumtimin e Ngjalljes së Krishtit. Në inflacionin e fjalëve që kaq shumë dëgjojmë çdo ditë, është tepër e nevojshme kjo ditë heshtjeje. Shën Gregori i Madh Papë, një herë pati thënë: 'Duke mos folur, mësojmë të heshtim, por duke heshtur, në qetësi të plotë, mësojmë të flasim më mirë'. Nata e Pashkëve, me ritet liturgjike të veta të bekimit të ujit, të zjarrit dhe të shpalljes së Ngjalljes së Krishtit, bën të shndrisë fytyra gjithnjë e re dhe e bukur e Kishës, e cila u kujton besimtarëve se Treditëshi i Pashkëve nuk është kujtim i realitetit të së kaluarës, por është realitet aktual. Krishti edhe sot, me dashurinë e tij fiton mbi mëkatën dhe mbi vdekjen. E keqja, në të gjitha format e veta, nuk do ta thotë fjalën e fundit. Në fund të fundit do të ngadhënjë Krishti, e vërteta, dashuria. Nëse jemi





gati të vuajmë e të vdesim me Të, siç na tregon Shën Pali në liturgjinë e Fjalës së kësaj Nate të Shenjtë të Pashkëve, jeta e Tij do të bëhet jeta jonë. Mbi këtë siguri mbështetet dhe ngrihet feja dhe jeta jonë e krishterë.

Pra, Treditëshi i Pashkëve arrin kulmin pikërisht në Natën që kremtohet ndërmjet të Shtunës së Madhe e të Dielës së Ngjalljes së Jezu Krishtit. E Shtuna, e treta ndër ditët e shenja të Pashkëve është, ndër të gjitha, më e pasura me rite, simbole, fjalë e shenja, që shprehin fitoren e Jezu Krishtit, Zot e Shpëtimtar mbi vdekjen dhe forcat e errëta të së keqes. Është shpresë që u ofrohet të gjithë atyre njerëzve që besojnë në Zotin e Kryqëzuar e të Ngjallur. E Shtuna e Madhe është pra një ditë lutjeje e agjërimit, jo si pendesë, por si pritje e dëshirë për bukën e vetme që ushqen me të vërtetë: bukën e të Ringjallurit. Nata e Pashkëve dallohet nga e Shtuna e bën pjesë në ditën e Pashkëve; është festa e vërtetë, është një Natë “nëna e të gjitha netëve”.

Simbolet liturgjike të Pashkës: Drita, fjala, uji dhe buka

Katër janë simbolet e liturgjisë së natës së Pashkëve, e cila kremton ringjalljen e Zotit: **drita, fjala, uji dhe buka**. Të gjitha shpjegohen me mënyrat me të cilat Jezusi e ka paraqitur veten: Jezusi është drita e botës, është fjala e fundit e Atit, është uji që shuan etjen e përtërin, është buka e jetës.

Nata e Pashkëve na bën të hyjmë në plotësinë e misterit të tij: na bën ta takojmë Jezusin si i Ringjalluri, i Gjalli, Ai që, duke na treguar fytyrën e

vërtetë të Atit, mund të na mbushë me gëzim e shpresë. Nata e Pashkëve është rrënja e çdo shprese dhe e kuptimit të krishterë të jetës. Kush e ndjek Jezusin për jetë, kush ka jetuar në ditët e mëparshme solidaritetin në dhimbje, tani mund ta jetojë me gëzim festën.

Nëse gjatë Kreshmëve kemi reflektuar mbi peshën e mëkateve e mbi rrezikun e dështimit në jetë, këtu fillon shpresa për një ndihmë nga lart, që i jep vlerë ekzistencës, megjithëse në mes të errësirës e dhimbjes. Bashkësive të krishtera, Nata e Pashkëve duhet t'u japë guximin për ta dëshmuar këtë shpresë, guximin për ta arsyetuar shpresën e jetës, që mbajnë në zemër. T'u japë aftësinë për të ndërmarrë impenjime e iniciativa, që i thonë botës sa e mbushur me të ardhme e me mundësi pozitive është feja në Jezusin. E tani të përshkruajmë e të përshkojmë së bashku ritet dhe simbolet liturgjike të Natës së Shenjtë të Pashkëve.

Liturgjia e dritës

Çasti i parë i Natës së Pashkëve e përqendron vëmendjen mbi dritën: zjarri i ndezur në errësirë kujton Shpirtin dhe ngrohtësinë e Zotit, forcën e tij ripërtëritëse, por edhe dashurinë njerëzore, që i jep ngrohtësi e kuptim jetës.

Imazhi i qiriut në procesion drejt kishës e thërret popullin e besimtarëve të ndjekë Jezusin, dritën e botës. Qiriu që jep dritë duke u konsumuar, si Jezusi, u thotë të krishterëve se askush nuk mund të jetë dritë për të tjerët, pa flijuar e hequr dorë nga vetvetja. Do të ishim të kënaqur nëse nga sakrificat tona të vogla, të tjerët të përfitonin ngrohtësi e jetë. Për disa aspekte, bota është akoma e zhytur në errësirë. Lajmi i Mirë i Pashkëve nuk mund të mbetet vetëm në një himn fjalësh të bukura. Kulti i vërtetë i të krishterit është jeta e Krishtit të Gjallë.

Ja me fjalë të tjera Shërbesa e Dritës: Bashkësia gjendet afër qiriut të Pashkëve që është simbol i Krishtit, dritës së botës. Në shërbesën e dritës së kësaj nate duhet të veçohen momentet si bekimi i zjarrit që është shenjë e jetës që shndrit dhe ngroh. Më pas në qiriun e Pashkëve meshtari gdhend një kryq. Mbi të vihet shkronja greke Alfa, ndërsa nën të shkronja Omega. Në katër anët e kryqit vihen katër numrat e vitit vijues, pastaj mund të vihen pesë kokrrat e kemit po kështu në formë kryqi. Prej zjarrit të bekuar ndizet qiriu i Pashkëve që simbolizon Krishtin e Ngjallur.

Pasi të jemi nisur drejt kishës, në hyrje të saj të gjithë ndezin qirinjtë që bartin në dorë nga qiriu i Pashkëve (Populli i Zotit udhëton në këtë botë i shndritur me dritën e Krishtit). Atëherë diakoni, ose nëse ai nuk është, meshtari, duke e lartësuar qiriun e Pashkëve këndon në hyrje të kishës, në mes dhe te altari: “Drita e Krishtit”, në çka të gjithë përgjigjen: “Falënderojmë Hyjin”.

Pasi të vihet qiriu në shandan, këndohet himni i qiriut të Pashkëve. Ky himn përmban pesë tema: 1) Ngjallja është krijim i ri; b) Dalja; Qiriu si udhëtrëgues i popullit (Dalja nga Egjipti); c) Qiriu është dritëza e Kishës e cila pret të Fejuarin e vet; d) Domethënia e paraqitjes së dritës dhe karakteri flijues i Pashkëve; dhe e) Simbolika e bletëve. Pasi të ketë përfunduar himni, të gjithë fikin qirinjtë dhe ulen. Vazhdon shërbesa e fjalës.

Liturgjia e Fjalës

Liturgjia ofron mundësinë e shumë leximeve: zgjedhja e të gjithave ose vetëm e disave prej tyre duhet të japë kuptimin e domethënien e një historie të përshkuar nga iniciativa e Zotit. Fjala bëhet histori e përgatitet të presë Jezu Krishtin.

Fjala është në fillim të krijimit, nëpërmjet të cilit Zoti dhuron të qenit, pra i jep kuptim gjithçkaje që ekziston. Në veçanti, krijon njeriun në përngjasim të Tij, duke vendosur tek ai farën e një prirjeje të natyrshme drejt Krijuesit të vet.

Fjala e Zotit udhëheq rrugën e çlirimit e të rithemelimit të popullit, që bëhet popull i Zotit nëpërmjet mundit e kërimit, gabimit e kthimit drejt Zotit.

Deri tek Ungjilli, ku tregimi i grave që e gjejnë varrin e Jezusit bosh e çon besimtarin tek Ai, që nuk duhet kërkuar ndër të vdekurit, tek i Gjalli, që duhet takuar në historinë e përditshme.

Ja me fjalë të tjera Shërbesa e Fjalës së Zotit: kur mendojmë mbi veprat e mrekullueshme të cilat që nga fillimi Zoti i ka bërë në popullin e vet. Për shërbesën e fjalës janë të paraparë shtatë lexime prej Besëlidhjes së Vjetër dhe dy prej Besëlidhjes së Re.

Leximet e BV mund të reduktohen në më së paku dy, por asnjëherë nuk guxon të lihet leximi mbi daljen prej Egjiptit (leximi i tretë). Pas leximit të fundit të BV dhe lutjes, meshtari këndon Lavdi... Vijon lutja dhe leximi i letrës nga Besëlidhja e Re. Kur ky përfundon, solemnisht pas shtatë javësh këndohet Aleluja. Vazhdon Ungjilli dhe homelia apo komenti i leximeve biblike.

Liturgjia e Pagëzimit

Është çasti që na çon tek jeta e re e marrë përmes Pagëzimit: është pra momenti-kujtesë i ngjarjes themelore të qenies sonë si Kishë. Përtëritja e impenjimeve, që të tjerët i kanë marrë për ne në momentin e Pagëzimit, do të thotë një vetëdije e re për përgjegjësinë tonë në histori. Ja me fjalë tjera Shërbesa e Pagëzimit: Sakrament ky përmes të cilit kemi kaluar nga vdekja në jetë. Bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit, dhe nëse ka katekumenë (kandidat[ë] të rritur për pagëzim, apo fëmijë) bëhet paraqitja edhe e nunëve, e pastaj kremtohet pagëzimi i tyre. Nëse nuk ka asnjë kandidat për pagëzim, bashkësia e besimtarëve ftohet në lutje dhe bëhet bekimi i ujit. E pastaj bëhet përtëritja e premtimeve të pagëzimit: në këtë rast nuk thuhet Besojma.

Liturgjia Eukaristike

Eukaristia e Natës së Pashkëve është një “akt falënderimi” krejt i veçantë: “Pashkët ishin momenti në të cilin e pati fillesën Eukaristia e vërtetë! Prandaj edhe misteri i natës së Pashkëve përqendrohet tek Eukaristia, të cilën Krishti nuk e paraqet i vetëm, por së bashku me Kishën e vet. Ajo merr pjesë në Eukaristinë e tij, që përruron solemnitetin e madh të Rrëshajave, në të cilat bashkësia e krishterë e shëlbuar falënderon Atin së bashku me Birin”.

Ja me fjalë tjera Shërbesa Eukaristike: Populli i Zotit i rilindur me pagëzim paraqet flinë në Përkujtim të Krishtit, si shenjë falënderimi dhe ushqehet me korpin e gjakun e Krishtit të Gjallë. Shërbesa Eukaristike është kulmi i këtij kremtimi me të cilën shprehet kuptimi themelor i saj: me praninë e Krishtin të Gjallë kalojmë nga vdekja në jetë të vërtetë. Kremtimi i Meshës vazhdon si rëndom me lutjet përkatëse e të përshtatshme të kësaj të Kremte, sipas Mesharit Romak. Kremtimi i Natës së Pashkëve nuk duhet të përfundojë para mesnatës, “sepse duhet të presim deri në atë çast të saktë kthimin e Hyjit”. Ajo Natë është e mbushur me misterin e pritjes. Qiriu qëndron pranë ambonit, i cili përfaqëson Varrin bosh. Ai është simbol i të Ringjallurit. Gratë që në mëngjes herët, shkojnë te varri për ta mbështjellë “trupin e vdekur” të Jezusit, me një vaj të përmortshëm gjejnë Fjalën e ngjallur. Nata e Pashkëve kremton krejt Misterin e festës e në çdo pjesë të saj kryhet kalimi nga vdekja në jetë. Kulmi i Natës është Eukaristia: buka e të Ngjallurit për bashkësinë e vet.

Radio Vatikani

Don Nosh Gjolaj
Podgoricë

MIRËNJOHJA E TË DREJTËS - SHOKUT TË MARTESËS

(Pjesa e dytë)

3. Ta kesh dinjitetin personal

Njeriu dallohet nga kafsha, e cila nuk është e vetëdijshëm për vete, dhe si e tillë nuk ka egon (unin). Me një fjalë, kafsha nuk e ka dinjitetin. Përderisa flasim vetëm për dinjitetin e njeriut, i cili kërkon arsyeje e fundit. Bie fjala, “qeni është i dëgjueshëm”, edhe pse i zoti i tij e rrah. Në qoftë se ndodh diçka e tillë me njeriun, atëherë themi se ai nuk ka fare nderim dhe dinjitet ndaj vetes, edhe çka është më e keqe, ai fare nuk ka vetëdijesim për dinjitetin e një njeriut të ngritur dhe të kulturuar. Si pas të gjithave parimeve: një njeri i tillë natyrisht është i zhveshur nga çdo lloj dinjiteti njerëzor, po ashtu edhe nga mjedisi ku jeton, dhe me plotë të drejtë e quajnë “dëgjesa e qenit”. Tipat e tillë nga natyra japin në shikimin e parë, si njerëz të përvuajtur dhe të devotshëm, por jo, ata janë të mos përfillur, të braktisur, moskujdesi ndaj vetvetes. Mospërfillja apo moskujdesi ndaj vetvetes, nuk ka asgjë të përbashkët me përlësinë e devocionit. Shumë bukur e pasqyron shembulli që vijon: Ja një nxënës i Diogjenit, cili entuziazmohet në

përlësinë dhe thjeshtësinë e mësuesit. Por ai për ta ndjekur mësuesin, filloi të vishej me një gardërobë të dobët, që ishte plotë vrma dhe arna, i shkarravitur dhe i palarë. Një prej ditëve i afrohet miku dhe e qorton: “I dashuri im, a nuk e sheh, se nga veshmbathja jote shpërthen mendjelehtësia nga çdo vrimë e gardërobës!” Po ashtu edhe mendjelehtësia nuk ka asgjë të përbashkët me dinjitetin e njeriut. Dinjiteti dhe thjeshtësia e përlësisë në këtë rast gërshetohen njëra me tjetrën dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Përlësia e natyrshme, i kundërshton mospërfilljes ose moskujdesit ndaj vetvetes, përderisa dinjiteti i njeriut i kundërshton mendjelehtësisë.

Dinjiteti i ndihmon njeriut të ndershëm për t'i pasuruar virtytet, me të cilat jo vetëm e pasuron veten por edhe bashkësinë martesore. Menjë fjalë është vlerë e domosdoshme për partnerët që dëshirojnë ta kalojnë jetën dhe ta ndajnë fatin përbashkët. Dinjiteti gjithherë shprehet te njeriu i sinqertë me një pamjeje reale. Detyra e tij është për ta ruajtur njeriun nga mendjelehtësia, mospërfillja,



me një fjalë njeriut mos t'i përvetësojë shprehitë e një rrugaçit të pagdhendur. Mungesa e dinjitetit shumë lehtë njeriun e shpie në vorbullën e një kafshës së egër, me sjellje të çoroditura dhe nënçmuese ndaj tjetrit. Fjala vjen, një vajzës, po qe se i mungon dinjiteti, ajo jo vetëm se e humb vajzërinë duke u bërë objekt i tjetrit për shfryrjen e epshit por edhe baraspeshën e jetës së ndershme.

Sot më tepër përdoret nocioni i thjeshtësisë në vend të përlulësinë. Njeriu që e posedon dinjitetin, po ashtu është edhe i thjeshtë. Thjeshtësia është një pjesë e dinjiteti dhe motra e sinqeriteti.

Njeriu i pjekur është i vetëdijshëm se nuk është i përsosur dhe nuk mund të bëjë gjithçka, sepse është vetëm njeri në rrugën e zhvillimit dhe përsosjes. Njeriu nuk lind shenjtë as i përsosur por gjatë rrugës ai arrit këtij qëllimit, po ashtu ai nuk e harron, se nuk është në këtë rrugën e zhvillimit i vetmuar, por ec edhe me tjetrin, i cili po ashtu i bartë me vete mungesat, dobësitë si edhe virtytet. Për një zhvillim dhe rrugë të mbarë duhet bashkëpunimi me tjetrin. Kuptohet vetvetiu se ndërtohet vetëm në raportet e sinqerta. Kjo është ajo rrugë që ia mundëson ta tejkalojnë vetveten dhe egoizmin për t'u ngrit mbi qeniet tjera të tokës.

Aty ku nuk ka përgjegjësi kuptohet se nuk ka as dinjitet njerëzor. Vëllezërit e dinjitetit janë virtytet, që i ndihmojnë njeriut për ta gjet atë rrugën e mesme, për t'u shmanga nga tundimi i skajshme, duke ruajtur baraspeshën e personit, si në raportin ndaj unit (egos) ashtu edhe në raportin ndaj tjetri (partnerit). Dinjiteti nuk e lejon krenarin për t'u ngrit deri në lartësitë e qiellit, po ashtu nuk e lejon mendjelehtësinë apo zhdukjen e vetvetes duke u shkriur në tjetrin, por qëndron trimërisht duke u ballafaquar me realitetin e jetës por njëkohësisht e ruan baraspeshën e normales.

Ky parim është i domosdoshëm për çiftin martesor. Në jetën e përbashkët në bashkësinë martesore është tundimi i përhershëm për ta shkel tjetrin ose tjetri e humb durimin dhe flijohet edhe shkrihet në tjetrin përkatësisht në zhdukjen e vetes. Preventiva është ilaçi më i miri, jo vetëm se e ruan veten në tërësi por e respekton edhe tjetrin ashtu siç është.

Atëherë mund të themi në kuptimin e fjalës, se rruga e bashkësisë martesore e realizon dashurinë, e cila nuk mbetet shterpët por është frytshme, me begatimet e shumta, siç është fryti i dashurisë - fëmija, jo vetëm për kënaqësinë e partnerëve por, ai fryti i tyre - do ta begatojë mjedisin, kombin, Kishën etj.

4. Vetëdijesimi dhe përgjegjësia martesore

Dinjiteti nuk është vetëm preventiva që e ruan çiftin martesor nga zhvlerësimin njerëzor dhe nga zhdukja e unit (egos) por ajo i ka edhe detyrat. Një prej detyrave është edhe përgjegjësia. Mungesa e dinjitetit shprehet edhe në mungesën e përgjegjësisë. Po qe se e njeriu e çmon vetveten, ai me siguri do ta ndiejë edhe detyrimin e përgjegjësisë për çdo punë, veprim dhe sjellje. Përdërisa njeriu pa dinjitet, çdo punë, veprim dhe sjellje që bën, nuk e merr përgjegjësinë mbi vete posaçërisht, pasoja ia hedh fajin tjetrit. Mos të flasim për sjelljen dhe jetën e pamoralshme dhe të çoroditur. Në të kundërtën, sa më tepër njeriu (partnerët) e përjetojnë vetëdijësimin e dinjitetin, aq më tepër u lajmërohet shprehia e përgjegjësisë. Ata kurrë nuk ia hedhin fajin tjetrit as s'e fajësojnë, por e marrin mbi veten përgjegjësinë.

Përgjegjësia e tejkalon vetveten (uni-egon). Partneri i tillë është largpamës. Çdo veprim, punë dhe sjellje mund të lërë pasojë, jo vetëm në bashkësinë e martesës por edhe më gjerë. Pasojat gjithherë e tejkalojnë qëllimin, që e kishte partneri. Ky vetëdijësim dhe largpamësi e ngarkon çiftin martesor me përgjegjësinë etiko-morale. Ja një shembull i trimërisë së gruas së një kujdestari, i cili kujdesohej për fenerin e detit në limanin francez, Belle Isleen, gjatë natës më 11.4.1911. Kujdestari e pastroi fenerin dhe e demontoj në pjesë-pjesë. Papritmas kujdestari u sëmur për vdekje dhe mëmësi arriti te shtëpia dhe ra në shtratin e vdekjes. Gruaja hutohet por pas një momentit të shkurtë ajo vetëdijësohet. Çka të bëjë, të kujdesohet për bashkëshortin e sëmurë apo të shkojë për ta ndrequr fenerin e prishur. Po qe se nuk shkon për t'i sinjalizuar vaporet, që kalojnë aty pari, mund të përplasen dhe e keqja është shumë më e madhe! Ajo vendosi të shkojë për ta ndrequr fenerin, ishte një përgjegjësi e madhe për të. Posa e montoi fenerin dhe vendosi në vendin e vet, e vërejti se nuk funksiononte. Vrapoi deri te shtëpia, i mori fëmijët e vet, njërin 7 dhe tjetri 10 vjeçar për t'i ndihmuar që të ngrihej deri te feneri, ashtu ajo u jepte vaporeve sinjalin e dritës me dorë, duke qëndruar ashtu deri orët e mëngjesit! Për këtë trimëri kuvendi i Francës vendosi për ta shpërblyer me "kryqin e nderit".

Njeriu i pjekur emocional me provoja jete, është jo vetëm largpamës por edhe përgjegjës i çdo veprës, punës, sjelljes. Po ashtu njerëzit e tillë, shumë më vështirë përcaktohen për ndonjë veprim ose punë. Përpara në mënyrë serioze i vlerëson eventualisht pasojat e mundshme. Për çdo ditë

njerëzit e tillë korrigjohen, pranojnë jo vetëm veten ashtu siç janë por edhe tjetrin (partneri). Ky parim nuk është vetëm detyrë por edhe detyrim i çdo bashkësie martesore. Për këtë detyrë kurrë nuk ka pushim, as dimër as verë, as vjeshtë as pranverë, as gjatë ditës as gjatë natës. Përgjegjësia është bija e dashurisë së pjekur, që e ngrit dhe e kultivon jo vetëm besimin mes partnerëve por edhe fushëveprimin e jetës.

5. Të tejkalohet frika

Si për çiftin martesor ashtu edhe për çdo individ tjetër është domosdoshëm guximi dhe mposhtja e frikës. Ai i cili nuk posedon virtytin e guximit ai nuk e merr përgjegjësin mbi vete. Shkolla e sotme dhe edukatorët shumë pakë e theksojnë këtë virtyt gjatë shkollimit dhe edukimit të rinjve dhe të rejave, posaçërisht as atyre që përgatiten për martesë, për jetën e përbashkët në bashkësi. Kuptohet vetvetiu, ai i cili e merr mbi veten përgjegjësin dhe gjitha pasojat që rrjedhin nga puna apo sjellja ata duhet me qenë jo vetëm të ngritur dhe me një dinjitet të vetëdijesimit të lartë por edhe guximtar. Ai, i cili nga natyra është frikacak, ai as përgjegjësin mbi vete nuk do ta marrin, posaçërisht në qoftë se është për ndonjë punë të rëndësishme, siç është fjala edhe bashkësia martesore, edukata e fëmijëve, kujdesi për familje etj. Ndjenjat e përgjegjësisë jo vetëm se kërkojnë në çdo hapë, në çdo moment dhe për çdo ditë, por njëherë edhe mposhtja e frikës. I cili nuk e mposht frikë, ai zakonisht do të mbesin gjysmak i pa zhvilluar, me pikëpamje të luhatshme, pa kurrizor, murmurimës dhe i pavendosur. Zakonisht tipat e tillë duken njerëz të mirë, të devotshëm, por ata jetojnë të ndamë në vetvete, në një anë kanë dëshirë të marrin pjesë qoftë në lojë, ndonjë argëtim, ndonjë veprim por në tjetrën anë nuk kanë guxim për t'u lajmëruar, janë mjaft të nguruar, dhe në fund të fundit e hanë vetvete dhe fajëson tjetrin pse nuk e kanë ftuar: "Vallë a nuk e kam merituar të shkoi në argëtim!" Me një fjalë njerëzit e tillë jetojnë mes dëshirave të fshehura dhe realitetin e dukshëm, për cilin nuk kanë guxim të deklarohen! Sipas psikanalizës, frustrimi i tillë e ka zanafillën nga mosha e njomë (fëmijës). Zakonisht njerëzit e tillë mbesin pa diplomuar, të pa martuar, në qoftë se martohen vazhdojnë me të njëjtin frustrim, që nuk mund të vendosin me ble shtëpinë, me ble veshmbathjen, mobilet, por zakonisht ia lënë tjetrin (partnerit) por në fund nuk është i kënaqur me vendimin apo me zgjidhjen e tjetrit.

Sa më i theksuar është frika aq më tepër kërkohet

guximi. Pothuaj te njeriun normal nuk ka ndonjë veprim apo punë (sjellje) që nuk e shoqëron pasiguria. Askush nuk mund të garantoj të ardhmen, sigurinë, pasojat eventuale. Pasiguria nga njëherë është e vogël e parëndësishme, por nga njëherë ajo është e madhe, saqë kërkon nga individ të rrezikojë. Me një fjalë tjetër. Njeriu posaçërisht partnerët në bashkësinë e martesës duhet për çdo ditë të rrezikoj. Pa ndonjë rrezikim nuk ka ndonjë vendim personal. Për këtë situatë ju dëshiroj t'iu them diçka nga libri i Leo Buscaglia: Të jetosh, të dashurosh, të kuptohesh:

"Po qeshët, ka rrezik t'ju marrin për budallenj." E pastaj? Ku ka më të gëzuar e më të kënaqur se budallenjtë?

"Po qajë, ka rrezik t'ju marrin për sentimentalë" Natyrisht që edhe unë jam sentimental. Më pëlqen! Lotët mund të jenë të dobishëm.

"Po vendose kontakt me një tjetër, ka rrezik të hysh në marrëdhënie të vërtetë." Cili është ai që rrezikon kaq? Unë, unë dëshiroj të rrezikoj! "Po i shfaq ndjenjat e tua, ka rrezik të tregosh unin e vërtetë." E pse ji, çfarë kam tjetër për të treguar? "Po shfaqët idetë dhe ëndrrat tuaja përpara turmës, ka rrezik që t'ju quajnë naiv." Oh, më kanë thirrur me epitete mjaft më të këqija.

"Po dashurove, ka rrezik mos të ta kthejnë me të njëjtën monedhë." Po unë nuk dashuroj që të ma kthejnë dashurinë.

"Po jetove, ka rrezik të vdesësh." Jam gati.

"Po shpresove, ka rrezik të dëshpërohesh; po tentove, ka rrezik të dështosh." Por është e nevojshme të kalosh rreziqet, sepse rreziku më i madh në jetë është të mos rrezikosh asgjë. Njeriu që nuk rrezikon asgjë, nuk bën asgjë, nuk ka asgjë, nuk është asgjë dhe nuk bëhet asgjë, nuk ndjen lumturinë as bukurinë e jetës. Mund të shmangësh vuajtjeve dhe ankthit, por nuk mund të mësohesh, të ndjesh, të ndryshosh, të përparosh, të dashurosh dhe as të jetosh. I lidhur me zinxhir nga siguritë e tua, bëhesh skllav. Ke hequr dorë nga Liria. Vetëm njeriu që rrezikon është me të vërtetë i lirë. Provoni dhe do të shikoni se ç'do të ndodhë.

Mos e harroni se në çdo drejtim që të kthehemi, jemi mjaft të kufizuar. E megjithatë e gjithë kjo mund të ndryshojë. Kemi mundësi të ndryshojmë programimin tonë të brendshëm dhe kjo është mjaft e lehtë, por duhet të jemi ne, ai që do të vendosmi. Pa mëdyshje, taman tani i themi vetes: "Do të filloj t'i besoj vetëm eksperiencës sime. Do të filloj të ndjej shijen e asaj që ha, t'i njoh vetë njerëzit, të

vrojtoj qiellin, do të ndjej përgjegjësi për ndjenjat e një tjetri, do të ndërgjegjësoj veten time për ndryshimet e mia, për përparimet e mia, për qenien time, ashtu edhe për dobësitë e mia.”

Pastaj mos ta humbim vetveten përgjithmonë. Nëse doni ta gjeni vetveten, mund ta bëni! Nuk keni humbur asgjë nga ajo që keni pasur. Nëse njëfarë kohe ndjeni përbrenda një zbrazëti të madhe, diçka që ju shkatërron e ju bren, diçka që ulërin përbrenda e kërkon të shpërthejë, është ajo e veçanta – unikja – e mrekullueshme që thotë: “Jam akoma” ! Jam akoma unë. Jam këtu brenda! Kërkomë! Zhvillo më! Shkëmbemë.” Vetëm atëherë kur ta ndjeni e ta kapni atë, do të filloni të zbuloni pak nga ajo që është thelbësore tek ju. Thelbësorja nuk gjendet “atje jashtë”. Ajo është “brenda nesh”.

Veçanti kur dobësohet vetëbesimi apo gjendemi në periudhën e pesimizmit apo të dështimit ose zhgënjimit, shikohuni në pasqyrë dhe qeshni, po vërtet qeshni me krejt fytyrën – me sy e jo vetëm me buzë. Shikoni me kujdes qeshjen tuaj; e ka ndriçuar fytyrën tuaj? Merrni qeshjen tuaj në shëtitje, ushtroni në shoqërinë e të tjerëve, ndikimi mund të jetë shumë i mirë. Shprehja e të qeshurit ju ndihmon që të shikoni përtej vetes, e ndonjëherë vetëm kjo ju nevojitet që të nxisni ndryshimin e ndjenjave tuaja dhe të shtoni vetëbesimin, optimizmin si dhe suksesin tuaj.

Jeta e përditshme dikton dinamikën e tillë, që duhet orë e çast të rrezikohet, për të cilën kërkohet shkundja e frikës dhe veshja e guximit. Guximi vetvetiu e mposht frikën qoftë atë të imagjinuarën qoftë atë objektive. Pjekuria e njeriut shprehet edhe në përgjegjësinë e guximshme, kuptohet nuk kërkohet ndonjë heroizëm apo ndonjë vepër jashtëzakonshme, por vetëdijesimi i plotë për çdo vepër, punë dhe sjellje që e bëjmë për çdo ditë, që e marrim përgjegjësinë e plotë, duke mos fajësuar atë tjetrin. Mes tjerash edhe shprehjet apo virtyti i guximit e ngritë njeriun mbi kafshë. Kafsha mund me qenë sulmues dhe e rrezikshme, në shikimin e parë e guximshme, por të gjitha këto veprime ajo i bë sipas instinktit. Sa shpejt e njëjta kafshë, siç fjala vjen, tigri (që është mjaft agresiv), e kaplon frika instinktive nga luani dhe menjëherë ai tërhiqet dhe fshehët në stofullin e vet. Përdërisa njeriu, i cili nuk ka fuqi për ta mëposhtëm frikën në vetvete, për një veprim trimëror. Këtë do ta bënte në qoftë se do të kishte mundësi krahasimit arsyes pro dhe jo, dhe atëherë me vendos, dhe ashtu ai e gjë atë kundërpeshën e frikës. Kundërpesha mund ta

shfrytëzoj po që se e çmon rrezikun duke mos dëmtuar unin dhe tjetrin pranë vetes. Në një mënyrë rreziku e tejkalon me sukses. Në qoftë se një student rrezikon dhe shkon në provimin, por ai ra në provim duke përjetuar disfatën. Në qoftë se ai student ishte nga natyra i dobët dhe frikacak, dhe me guximin e ndërmarr, ai e thyen akullin e frikës dhe si i tillë del fitimtar, sepse e ka tejkaluar vetveten dhe e ka mposht frustrimin e frikës.

Po që se njeriu është me një baraspeshë normale dhe rrezikon, ai duhet t'i marrin mbi vete edhe përgjegjësinë e pasojave. Po ashtu në bashkësinë martesore i japin kurajë njëri-tjetrit duke e zhveshur nga frika dhe duke marr guximin e baraspeshës e jetës normale. Në këtë zbulohet edhe dinjiteti dhe fisnikëria e njeriut që i kurorëzon dashuria ndërsjellat. Ky princip është i domosdoshme për partnerët që jetojnë në bashkësinë martesore, po ashtu edhe për çdo bashkësi njerëzore. Sot është mirëseardhur si asnjëherë tjetër, sepse si familja ashtu edhe bashkësia njerëzore është në krizë. Njeriu i sotëm edhe sa do është i pasur materialisht ai jeton në një frikë të përhershme, që e shoqëron ankthi, pasiguria, mërzia, depresioni, stresi, pesimizmi etj. As familja sa do është ideale nuk e kursen virusi i frikës. Pothuaj në çdo hapë ballafaqohemi me shkurorëzime, konflikte, mosmarrëveshje, kanibalizmin martesor. Njeriu me unin e fortë dhe me pikëpamjet e shëndosha, ai për çdo ditë orvatet për t'ia krijuar vetes horizontin e optimizmit, duke mposhtur frikën, ankthin, mërzinë, stresin dhe duke dhen kurajë vetes dhe partnerit me përgjegjësinë e guximshme. Kurse me pikëpamje pesimiste nuk do të shkojmë larg!



Don Prend Kola

Zvicër

FJALORTH LITURGIK

(Pjesa e tretë)

Adhurim-i. Gr. *λατρεία*; lat. *adoratio*. Shfaqje e dashurisë së zjarrtë dhe e nderimit gjatë historisë së shumë popujve përkundrejt një hyjnie ose një tjetër qenieje, për të cilët mendohet të jenë të mbushur me forcë hyjnore, duke iu përmbysur a rënë në gjunjë (*προσκύνησις*); nderim i madh ndaj Hyjit duke e pranuar si një Zot të vetëm, që tradicionalisht përcillet me shtrirje përtokë, gjunjëzim dhe përkulje; nderim, përlulje a falje që, sipas Shkrimit të Shenjtë, i përkasin vetëm Hyjit (krhs. *Ps*, 81,10; *Mk* 4,10) dhe Jezu Krishtit (krhs. *Zb* 4,11; 5,8–11); shfaqje e kultit, mahnitje e jashtëzakonshme për ekzistencën e Hyjit; falje ndaj Zotit me fjalë, gjeste dhe shikime: në këmbë, ulur, me gjysëmpërkulje ose përkulje të plotë, në gjunjë dhe gjeste të tjera të duarve, si dhe duke drejtuar shikimin dhe vështrimin lart; përbërës liturgjik në kremtimin e Meshës gjatë Shndërrimit dhe pas kungimit, me ç'rast të pranishmit gjunjëzohen; nderim i veçantë që në Kishën katolike dhe ortodokse i përket vetëm Hyjit trinitar, dhe dallon qenësisht nga vlerësimi i veçantë (*dulia*) kundrejt Virgjërës Mari, shenjtërve dhe ikonave.

Albë-a. Lat. *albus*, “e bardha”. Rrobë liturgjike e gjatë deri te këmbët për të mbuluar tërë trupin, të cilën e bartin të gjithë shërbestarët në kremtimin e Meshës nën meshoren dhe, nisur nga Kisha e hershme dhe tradita e saj, simbolizon petkun e pagëzimit dhe vishet për ta shtuar bukurinë e veprimit të shenjtë në kremtimin e Meshës; rrobë liturgjike që lidhet rëndom me një fill a brez, i quajtur, sipas latinishtes, *cingulum* dhe bartet jo vetëm nga kryemeshuesi dhe të gjithë bashkëkremtuesit, por dhe nga ministrantët. “Veshja e shenjtë e që e kanë të përbashkët shërbestarët e shuguruar dhe të emëruar të cilitdo rang është alba, e cila lidhet në mes me një brez, veç nëse ajo është e prerë në mënyrë që e lejon atë të rrijë mirë pa të. Para se të vishet alba, nëse ajo nuk e mbulon tërësisht veshjen e zakonshme të qafa, duhet veshur një amikt. Alba nuk mund të zëvendësohet me një roketë, as përmbi një talar, në rastet kur ka për t'u veshur një kazulë ose një dalmatikë ose kur, sipas normave, vishet vetëm një stolë pa kazulë ose dalmatikë” (*Rregullorja e Mesharit*, 336); veshje liturgjike edhe në Kishën luteriane, të cilën e bartin shërbestarët e saj edhe kur

predikojnë, edhe kur kremtojnë Gostinë e Mbrëmjes; veshje e shenjtë në Kishën ortodokse dhe në kishat katolike lindore e ngjashme me stikarin (*στικάριον*).

Aleluja. Heb. *hallelu-Jáh*, “lëvdoh”. Pasthirmë, klithje, britmë urimi dhe gëzimi drejtuar Hyjit me burim liturgjik të pashtershëm në brohorinë e Pashkëve; thirmë liturgjike që, përkthyer fjalë për fjalë, do të thotë përlëvdoni Hyjin, lavdëruar qoftë Perëndia; lartësoni, lëvdoni, madhëroni, përhimnoni, thurni lavde Jahveut (Hyjit, Zotit, Perëndisë, (krhs. *Ps* 106,1.48); brohoritje drejtuar Krishtit të Ngjallur, njëzëshmëri ungjillore, thirrje e përbashkët para leximit të Ungjillit, e porositur nga Rregullorja të Mesharit për t'u kënduar doemos, sepse është brohoritje solemne. Aleluja jo e kënduar, mendohet të jetë kundërshti në vetvete. Pra, gjykuar sipas këtij mendimi, mund të thoshim: *Aleluja* e kënduar është një fanfarë, bori, trumbetë, për të bërë me dije të pranishmit se Krishti tanimë do të na flasë me fjalën e vet. Porsi *amen* dhe *hosana*, as *aleluja* nuk përkthehet. Pasi që mbetet e papërkthyer për cilëndo gjuhë qoftë ajo, thuhet se, mund të kuptohet edhe më mirë rëndësia e saj.

Amen. Heb. *amen*, “me të vërtetë, ashtu është”. Thirrje njëzëshmërie në kremtimin e Meshës dhe në të tjera kremtime liturgjike, me prejardhje hebraike, nga judenjtë ose xhudhitë (etnonim mesjetar i judenjve, me zanafillë nga ilirishtja) për nga fjala dhe vetë përdorimi, që do të thotë: besoj; ashtu qoftë, e vërtetë është (*Jer* 11,5; 1 *Mb* 1,36); formulë njëzëshmërie, që gjendet në Bibël rreth 125 herë, prej tyre 102 herë në Besëlidhjen e Re, dhe shpreh miratimin e bashkësisë dhe anëtarëve të saj në kremtim; brohoritje e popullit në kremtimet liturgjike, me anë të së cilës pëlqen dhe vërteton, pranon dhe dëshmon: po, besoj!; emërtim a titull i Krishtit (*Zb* 3,14) me të cilin bashkësia e mbledhur në lutje pranon çdo gjë që kumton Kisha dhe ushqen fjalën e saj; shenjë e pjesëmarrjes së besimtarëve në lutje dhe pranim para marrjes së kungimit se në të është Korpi i Krishtit; shprehje në kultin judaik, i njëjtë me përgjigjen e popullit në liturgjinë e Sinait gjatë rinjohjes dhe miratimit (ratifikimit) të Besëlidhjes: “Gjithçka tha Zoti do të zbatojmë e do të jemi të dëgjueshëm”; fjalë përmbyllëse e lutjeve edhe në islam. Ka raste të

rralla kur përkthehet fjala *amen*. Mirëpo, në Septuaginta (përkthimi i Biblës hebraike në greqishten e vjetër), në vend të *amen*, haset *yévoito*, që do të thotë: “le të ndodhë”. Në uratat e vjetra, të përkthyer në gjuhën tonë, e hasim të përkthyer: ashtu qoftë! Ose shpesh edhe: Amen. Ashtu qoftë!, që ende përdoret nga disa të moshuar. Fjalorët e gjuhës shqipe rëndom përdorin *amin*.

Anaforë-a. Gr. *ναφορά*, “lartësim, madhërim”. Shprehje liturgjike e riteve lindore për të bërë të ditur lartësimin e zemrës ose të dhuratave; emërtim i patristikës greke për Flinë eukaristike, në të vërtetë, zbatimit të kushtimit në Lutjen eukaristike, e caktuar të thuhet nga kryesuesi i kremtimit të Meshës në emrin e tërë bashkësisë duke i shprehur lavd e nder Trinisë së Shenjtë; Kanoni i Meshës ose Lutja eukaristike që nga dialogu i hapjes duke përfshirë anamnezën, epiklezën, doksologjinë, memento-n (lutjen për Kishën dhe tërë botën, për të gjallët dhe të vdekurit), dhe duke përfunduar me *amen*, si miratim i të gjithë atyre që marrin pjesë në kremtim; shprehje tipike dhe pjesë qenësore në liturgjitë lindore, e cila përfshin lutjen eukaristike mbi kushtesat, kallëzimin e Darkës së Fundit, Ati ynë, thyerjen e bukës dhe kungimin. Në shumicën e gjuhëve liturgjike orientale mbetet e pa përkthyer dhe shënon tërë liturgjinë eukaristike.

Anamnezë-a. Gr. *ἀνάμνησις*, “përkujtim”. Lutje në kremtimin e Eukaristisë, menjëherë pas fjalëve të shugurimit që, bashkë me paraqitjen e përbërësve eukaristikë, bukës dhe verës, përmes priftit, shpreh mendimet e Krishtit: “Bëjeni këtë në përkujtimin tim!” (Lk 22,19; 1 Kor 11,24–25); shprehje e përkujtimit solemn të veprave shpërblimtare të Hyjit në pjesën qendrore të Meshës; njëmendësi i përkujtimit të Krishtit duke kujtuar veçanërisht Mundimin e tij, Ngjalljen dhe Ngritjen në Qiell; formulë lutjeje e trashëguar nga zanafilla e krishterimit, e përmendur edhe te shkrimet e Shën Hipolitit të Romës (rreth † 235), emrit të të cilit i ngjitet vepra *Traditio Apostolica*; pjesë përbërëse e Lutjes eukaristike me trajtësime të ndryshme, me ç’rast ftohen të pranishmit për të sjellë në mend se Krishti hoq mundimet e kryqit, u ngjall të tretën ditë, sipas premtimit, dhe u ngjiti në qiell në lavdinë e Atit; lutje në të cilën “Kisha ia paraqet Atit flinë e



Birit të tij, e cila na pajton me të” (*Katekizmi i Kishës Katolike*, 1354). Një shembull i anamnezës nga Lutja III eukaristike: “Duke kremtuar, o Zot, përkujtimin e Mundimeve shpërblimtarë të Birit tënd, si edhe të ngjalljes së tij të madhërueshme dhe të të ngjiturit e tij në qiell e duke pritur ardhjen e tij të dytë, po ta kushtojmë me falënderim këtë fli të gjallë e të shenjtë” (*Meshari Romak*, f. 404).

Anijatë-a. Lat. *navis*, “anije”. Shtrirje qendrore përgjatë Kishës, në të vërtetë hapësirë gjatësore nga hyrja deri te altari, e ndarë me anë të një rreshti shtyllash; qasje qendrore përkundrejt altarit në arkitekturën kishtarë, e zgjatur në mes dy rreshtash me shtylla që nga hyrja, qoftë në stilet e kishave klasike, romanike ose gotike me dy ose edhe më shumë anësore të ndara nga njëra-tjetra me rreshtin e harknajave; emërtim që lidhet me formën e trungut të anijes, e cila simbolizon Kishën të udhëhequr nga Shën Pjetri dhe pasardhësit e tij; vendi kryesor ku rrinë besimtarët që e përbëjnë bashkësinë liturgjike, për të cilën Meshari veçanërisht përcakton: “Vendet duhet të renditen për besimtarët me kujdes të mjaftueshëm, me qëllim që ata të mund të marrin pjesë në kremtimet e shenjta me sy dhe me shpirt, në mënyrën e duhur. Është e përshtatshme që atyre rëndom t’u sigurohen banka ose ulëse ... bankat ose ulëset duhet të renditen, veçanërisht në kishat e reja, në mënyrë të tillë që besimtarët të mund të mbajnë lehtë qëndrimet e trupit të kërkuara për pjesët e ndryshme të kremtimit dhe të mund të shkojnë lehtë përpara për të marrë Kungimin e Shenjtë. Duhet pasur kujdes që besimtarët jo vetëm të mund të shohin priftin, diakonin dhe lexuesit, por edhe t’i dëgjojnë ata me ndihmën e teknikave moderne” (krhs. *Rregullorja e Mesharit*, 311).

Lorenzo Rossetti

Lezhë

NATYRA DHE MISIONI I KISHËS
sipas të lumit Pali VI
Skicë e enciklikës *Ecclesiam suam* (6. 08. 1964)

I lumturuar me datë 19 tetor të vitit që shkoi, Pali VI ka lindur në jetën e krishterë duke marrë sakramentin e Pagëzimit me datë 30 shtator të vitit 1897, pikërisht ndërsa Tereza e Lisieux, lindte në jetën e pasosur në Qiell!

Me datë 2014 ka festuar 50 vjetorin e enciklikës së tij të parë, “*Ecclesiam suam*” me titull “Mbi natyrën e Kishës”. Dihet se zakonisht, shkrimi i parë i një pape është ai kryesori, themelori, në të cilin shfaqen shqetësimet më të mëdha dhe nxitjet më të larta ndaj të gjithë misionit të tij baritor. Një tjetër rastësi e veçantë: papa e nënshkroi me datë 6 gusht, ditën e Festës së Shndërrimit të Zotit, që do të jetë edhe ajo e kalimit të tij tek Ati në vitin 1978.

Ja vlen të ulim vështrimin në këtë tekst vendimtarë, veçanërisht për dashamirët e Kishës. Ai është, së bashku me *Mystici Corporis* i papës Piu XII (1943) dhe me *Lumen Gentium* (1964) e Vatikanit II, njëri nga shtyllat e ekleziologjisë katolike të shekullit XX.

Teksti fillon me një “Prolog” në të cilin Papa kujton se doktrina e krishterë nuk është veçse jehona e ungjillit në të mirë të të gjithë familjes njerëzore. Kishës i rëndon një “angazhim i trefishtë”: ajo e gjallërimit të *vetëdijes* mbi

vetveten; të angazhohet për një *rinovim* dhe të hapet ndaj *dialogut* me të gjithë. Tema të tjera si paqja dhe zhvillimi i popujve do të shtrohen në Koncil (që ishte ende në zhvillim) dhe nga magjisteri në vazhdim.

Teksti i letrës përbëhet pra nga tre pjesë: Vetëdija që Kisha ka për vetveten (I). Rinovimi (II). Dialogu. Do vëmë në dukje tani vetëm pikat më vendimtare të secilës prej këtyre pjesëve.

I) Pjesa e parë: Vetëdija

Të gjithë besimtarët janë për vigjilencë dhe për “shoshitjen e plotë” (Fil 1,9). Papa fton për një veprim besimi (“Besoj, Zot!”), që është edhe veprim vetëdijeje. Vetëm nëse ka një vetëdije të mirëfilltë të të qenit të krishterë, të të qenit Kishë secili mund të jetojë thirrjen e tij. Një lëvizje e tillë rizbuluese duhet të ndodhë nën dritën e Shpirtit të Shenjt që mëson çdo gjë dhe frymëzon në mënyrë të veçantë Magjisterin e kishës (Gjn 14,26). Në kohën moderne doktrina e Kishës është pasuruar veçanërisht me Vatikanin II, me enciklikat e papës Leone XIII dhe mbi të gjitha të papës Piu XII, por edhe me punën e shumë teologëve që kanë bërë të



rritet shkenca mbi trupin mistik. Dhe tema e Kishës është në qendër të diskutimeve të Koncilit të Vatikanit II. Nën dritën e mësimin të Shën Palit mbi Kishën si trupi i Krishtit dhe të imazhit të ungjillit të Shën Gjjonit të Hardhisë dhe shermendeve (krh. Gjn 15), Pali VI kujton të vërtetën themelore se duhet të mësohemi “*të njohim në kishë të të njëjtin Krisht*” (Piu XII) dhe të brohorasim me Shën Agustinin: “...të gadojmë dhe falënderojmë, jo vetëm që jemi bërë të krishterë, por Krisht. A e kuptoni, o vëllezër, a e kuptoni j dhuratën e Hyjit për ne? Jini plot me admirim, kënaquni: ne jemi bërë Krisht. Sepse nëse ai është kreu, ne jemi pjesët: njeriu i plotë, ai dhe ne... Plotësia para e Krishtit: trupi dhe pjesët. Çfarë janë trupi dhe pjesët? Krishti dhe Kisha” (Joa. Tr. 21,8) *Christus facti sumus...* është ky misteri më i mirëfilltë dhe i thellë i Kishës: të jesh prani i Krishtit në botë. Zoti banon në ne me anë të besimit (krh. Ef 3,17) dha që këtu buron “kuptimi i Kishës” që gjallëron çdo të krishterë. Por Kisha nuk njihet mirë nëse nuk e jetohet, nuk duhet: “Misteri i Kishës nuk është thjeshtë objekt njohjeje teologjike, duhet të jetë një diçka e jetuar”. Në Kishën e Krishtit komunikon të vërtetën e tij, hirin e tij, njësinë e tij dhe e bën trupin e tij, ndërtim të cilin Ai është arkitekt dhe njeriu Pjetër themeli njerëzor (krh. Mt 16,18). Nëse e njohim nga brenda kuptohet se si Kisha mund të bashkojë në vetvete realitete të tendosura për të mos thënë të kundërta: “kisha e dukshme është shpirtërore në të njëjtën kohë, e lirë dhe në të njëjtën kohë e disiplinuar, bashkësi dhe hierarkike, e shenjtë tashmë dhe gjithnjë në drejtim të shenjtërimin, kundruese dhe vepruese”. Dhe kjo njohjeje të Kishës dhe misterit të saj shpie në një jetë të brendshme, të gjallëruar nga Shpirti Shenjt dhe e ushqyer nga trashëgimia e pasur e doktrinës kishtare. Përfundimi i këtij kapitulli mbi ndërgjegjen kishtare është i gjithi i përqendruar mbi themelin fillestar që është sakramenti i Pagëzimit. Ja vjen të citohet i gjithë paragrafi:

“Duhet t’i japim faktit që kemi marrë pagëzimin shenjtë, dhe domethënë që jemi futur, me anë të këtij sakramenti, në trupin mistik të Krishtit që është kisha, të gjithë rëndësinë e sajë, veçanërisht në vlerësimin e ndërgjegjshëm se pagëzimi duhet të ketë në lartësimin e tij, përkundrazi në rigjenerimin e tij ndaj realitetit tejet të lumë prej të birësuarit të Hyjit, në dinjitetin prej vëllai të Krishtit, në fatin, duam të themi në hirit dhe galdimit të banimit të Shpirtit Shenjt, në thirrjes për një jete të re, që asgjë nuk ka humbur nga njerëzorja, pos fatit të palumtur të mëkatit të rrjedhshëm, dhe asaj që sa është

njerëzore është e thirrur të jap shprehjet më të mira dhe të provojë frytet më të pasura dhe të pastra. Të qenit i krishterë, të pasurit marrë pagëzimin shenjtë, nuk duhet konsideruar si gjë e papërfillshme apo shkujdesshëm; por duhet të shënjojë thellë dhe lumturisht ndërgjegjen e çdo të pagëzuari; duhet me të vërtetë të konsiderohet nga ai, siç qe për të krishterët e lashtë, një ndriçim, që duke lënë të bie mbi të rrezja gjallëruese e së Vërtetës hyjnore, i hap qiellin, ja kthjellon jetën tokësore, e aftëson që të eci si bij të Hyjit, burim i lumturisë së pasosur. Dhe cilin program praktik ky këndvështrim vë para nesh dhe shërbesës sonë shihet qartë. Ne kënaqemi duke parë që një program i tillë është në zbatim e sipër, pranë të gjithë kishës, dhe i nxitur me zell të mençur dhe të zjarritë. Ne e inkurajojmë; ne e rekomandojmë; ne e bekojmë”.

II) Pjesa e dytë: Rinovimi

Këtu i mësohet nevojës së pandërprerë të rinovimit, të formës, të ndreqjes së të metave që gjithmonë shfaqen gjatë historisë së Kishës së dukshme. Kjo si pasojë “përsosërimit” të përditshëm të të krishterëve. Në këtë kuptim mund të flasim për *reformë* si përpjekje e vazhdueshme dhe e dobishme e të bërit të Kishës gjithnjë e më të pastër dhe të bukur sipas planit fillestar të Krishtit. Por duhet të ruhem nga të vepruarit dhe të menduarit sipas një konceptimi të thellë të jetës. Të krishterët janë në botë, por jo të botës. Duhet të mundim tundimin e mos lëvizshmërisë me një “*përditësim*” të shëndoshë (siç thoshte Gjoni XIII) duke shoshitur atë që është e mirë (krh. 1Ts 5,21). Udha e reformës së mirëfilltë nuk do të jetë një përshtatje ndaj shpirtit të botës, por një prirje e të jetuarit sipas hirit hyjnor, besnikërisë ndaj ungjillit, kohezionit hierarkik dhe të bashkësisë me përvujtëri, bindje e shpirt sakrificë e varfërie, duke u njëtrajtësuar me ndjenjat e Krishtit (krh. Fil 2,5). Mbi të gjitha me shpirtin e dashurisë (“Dashuria sqaron gjithçka. Dashuria frymëzon gjithçka. Dashuria gjithçka e bën të mundur. Dashuria ripërtërinë gjithçka”) dhe duke e mbajtur vështrimin nga Maria.

III. Pjesa e tretë: Dialogu

Të krishterët janë të thirrur të jetojnë në botë pa qenë të botës (krh. Gjn 17,15 e vazhdim), pa u njësuar me mendësinë e botës, por duke shfaqur jetën e re të pagëzimit (krh. Rom 12,2;6,3 e vazhdim). Duke pasur parasysh se detyra e parë e



Kishës është ajo e shpalljes së Krishtit, e ungjillëzimit (krh. Mt 28,19). Këtij misioni papa Pali VI i jep emrin dialog. Dhe në të vërtetë e gjithë rivelacioni i krishterë paraqitet si një dialog shpëtimi mes hyjit dhe njeriut. Është Hyji që merr nismën dhe që shfaqet falas dhe pa e detyruar lirinë e njeriut. Ai i drejtohet të gjithë njerëzve.

Mesazhi i krishterë është i thirrur që të vendoset brenda disa rrethanave të bisedës mbi njeriun. Si mënyrë apostolike, dialogu duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, i butë, besimtarë dhe i kujdesshëm. I gjallëruar nga një mençuri e mirëfilltë e aftë të zbulojë “elementë të vërtete edhe në opinionet e të tjerëve” dhe gjithnjë i prirur për të afruar vëllezërit drejtë plotësisë së jetës. Kjo ka të bëjë me artin e bërjes gjithçka dhe çdokush (krh. 1kor 9,22) me dashuri të vërtetë vëllazërore. Por e gjithë kjo nuk mund të shkojë në dëm të së vërtetës dhe parimeve për të besuar irenizma sinkretik. Mbetet pra predikimi si pjesë përbërëse e pazëvendësueshme, si katekishtike apo liturgjike.

Me kë bëhet dialogu? Papa dallon disa “rrathë”:

- Rrethi i parë përbëhet nga të gjithë njerëzit. Sigurisht, ateizmi, domethënë mohimi i Hyjit, është një pengesë për dialogun, por edhe me jo besimtarët duhet të hymë në komunikim. Nganjëherë Kisha dënohet për të qenë e heshtur (krh. Kisha në botën komuniste). Qasja do të frymëzohet gjithmonë nga dashuria e durimi i kujdesshme dhe i zgjuar. Në lidhje me këtë, dialogu për paqen paraqet një bazë

komunikimi me çdo njeri vullnetmirë.

- Rrethi i dytë: *besimtarët në Hyjin*. Kisha nuk dyshon se “Vetë Hyji i ka shfaqur formën, pa asnjë gabim, të përsosur dhe përfundimtare me anë të cilës Ai dëshiron që të njihet, të duhet dhe të shërbehet; që përkundrazi, të detyruar nga ndershmëria, ne duhet të shfaqim bindjen tonë se i vetmi besim i vërtetë është ai i krishterë, dhe që kemi shpresën se e tillë do të njihet nga të gjithë kërkimtarët e adhuruesit e Hyjit”, megjithatë dialogu përbëhet edhe nga njohja me respekt e të gjithë asaj që besimet e tjera fetare dhe kulturat e tjera mikprerin si të vërtetën brenda vetes.

- Rrethi i tretë: *të krishterët e ndarë*. Me to vihet në dritë më parë ajo që na bashkon dhe ajo që mund ti lejohet atyre, por pa lëshuar pe në lidhje me “integritetin e besimit”. Roli Pjetrit duhet të bashkojë në vend që të ndajë! “Dëshirojmë të përgjërohemi për Frymën e Shpirtit Shenjt mbi “lëvizjen ekumenike””. E ardhmja duhet se na fal shpresa të vlefshme për një bashkim.

- Së fundi: dialogu *brenda kishës katolike*. Në bashkësinë e krishterë duhet të mbretërojë së bashku dashuria me liri të përjetuar dhe përvujtëri të bindur. “Kisha është e gjallë sot më shumë se kurrë! Por po të shohim mirë duket se gjithçka duhet bërë akoma; puna fillon sot dhe nuk përfundon kurrë. Është ky ligji i shtegtitimit tonë në tokë dhe në kohë.”

Don Lush Gjergji
Prishtinë

**STUDIUES I VYER
ATË EMANUELE GIORDANO
(1920-2015)**

Prishtinë, 5 mars 2015

Atë Emanuele Giordano-n për herë të parë e kam takuar në Kalabri, në famullinë Ejanina në vitin 1970. Ishte Java e Madhe. Me ftesë dhe përcjellje të Mons. Eleuterio Fortino, së bashku me Don Ndue Gjergjin, Don Aleksandër Kolën, udhëtuam prej Romës për Kalabri. Ishim studentë të Universitetit “Urbaniana.” Qëllimi dhe synimi ynë ishte për t'i njohur dhe takuar vëllazëritë tanë Arbëreshë, “*gjakun tonë të shprishur*” gjatë shekujve, por gjithnjë të gjallë dhe të ngrohtë. Ishim mysafirë të familjes së Mons. Eleuterio Fortino, në fshatin e njohur San Benedetto Ullano, vendlindja e tij. Ai na kishte mundësuar këtë vizitë, takim, njohje me botën arbëreshe.



Ndër takimet e paharrueshme, përpos vizitave gati të të gjitha bashkësive arbëreshe, rriteve të liturgjisë lindore, ishte edhe takimi, ndeja, bisedimi me atë Emanuele Giordano-n, njeri i ngritur, me kulturë të lartë, njohuri të thellë dhe dashuri të madhe, me fytyrë tipike dhe karakteristik arbërore.

Na bëri përshtypje erudicioni i tij për gjuhë, histori, letërsi dhe kulturë shqiptare. Biblioteka e tij ishte plot me libra. Mendova dhe vendosa: në duar dhe bibliotekë të tij ka vend edhe për botimet tona, për revistat fetaro-kulturore *Kumbona e Dieles* dhe *Drita*, që kishin filluar botimin në Shkodër pikërisht në Prizrenin tonë të lashtë.

Qysh prej takimit tonë të parë rregullisht ia kemi dërguar Dritën, më vonë edhe disa botime të tjera, *Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri*, *Nëna jonë Terezë*, *Besëlidhja e Re...* Çdo herë përgjigjej me fjalë të zgjedhura miradije dhe falënderimi, virtyt ky i njerëzve të mëdhenj dhe të mirë.

Takimi ynë i dytë ndodhi gjatë vizitës ndër Arbëreshë për mbledhjen e punimeve dhe

krijimtarive kushtuar Nënës Terezë për monografinë “*Lule për Nënë*”. Ishim së bashku me Don Zef Gashin, famullitarin e atëhershëm të Prishtinës, tani aripeshkvin e Tivarit, gjatë verës së vitit 1984.

Takimi i ynë i tretë ishte prapë në Ejaninë, më 8 shkurt 1985. Me këtë rast ndër të tjera më tha kështu: “Ti ma dërgon rregullisht Dritën dhe shumë botime tjera ... Unë të kam borxh... Ja, pra, Fjalori i Arbëreshvet t'Italisë, 1963, fq. 592, me këtë përkushtim: “*Mikut dhe Vëllaut të përdashur Lush Gjergjit. Me nderime dhe mall arbëresh. Papas Emanuel Jordani. Janinë, 8. II. 1985*”.

Takimi ynë i katërt ishte me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë në Kalabri, ndër Arbëreshë (11-13 maj 2013). Isha së bashku me vëllain tim, Don Ndue Gjergjin, misionar te “*Kisha Zoja Pajtores e Shqiptarëve*” në Southfield të Detroitit.

Para një viti mësova nga nipi i tij Augustin Giordano, drejtori i revistës “*Jeta Arbëreshe*”, pjesëmarrës në Seminarin për Gjuhë, Letërsi dhe

Kulturë Shqiptare në Prishtinë, se atë Emanuel Giordano fatbardhësisht ishte ende gjallë dhe mirë me shëndet.

E përshëndeta dhe ia dhurova disa libra nëpërmjet nipit Agustinit me dëshirë që të shiheshim sa më pare për t'i përtërirë kujtimet tona.

Mezi prita të takoheshim prapë, pas shumë viteve. E gjeta në tavolinë të punës, të rrethuar me libra dhe shkrime. Ishte mjaft i freskët me mend dhe shumë i lumtur që rishtas ishim së bashku. I thashë: *"Atë Emanuel, dashuria jonë është më e forte se koha dhe rrethanat e jetës. Ta solla edhe kësaj radhe një libër me meditime: Të ftuar dhe të dërguar"*.

Pas dy ditësh u ktheva rishtas për ta parë dhe ftuar në manifestimin qendror të Pavarësisë së Shqipërisë. E gjeta më librin tim në tavolinë. Më tha: *"Bukur, u kënaqa në lexim dhe meditim. Erdha deri te faqja 28. Gjithnjë lexoj ndonjë rresht, mendim apo faqe. Janë tekste të bukura dhe përmbajtjesore..."*. Upërgjigja: *"Ti më do dhe shi për këtë edhe me çmon dhe nderon, I shijon edhe dromcat e vogla në sofër..."*.

Pastaj ia shpjegova argumentin e ardhjes tonë dhe si në hoka i thashë: *"Ti i përket asaj periudhe, sepse linde vetëm tetë vite pas Pavarësisë. Eja, pra, e na ndero me praninë dhe fjalën tënde!"*.

Erdhi. Ishte shtrënguar mirë e mirë. Prania e tij i gëzoi shumë gjithë të pranishmit. I tha edhe dy fjalë rasti, dukshëm i emocionuar dhe ngazëllyer. Fjala e fundit ishte: *"Urime, urime, dhe prapë urime!"*.

Njeri për mrekulli në atë moshë! Mirë thotë populli ynë: *"Nuk plakët zemra dhe dashuria!"*.

Hera e pestë, e fundit, ishte kur pata përtëritjen shpirtërore për meshtarë dhe murgësia të Eparisë së Ungrit, me ftesë të Imzot Renato Oliverio (14 – 15 maj 2014).

Atë Emanuele Giordano qetë, ndërroi jetë; kaloi në amshim, u kthye në shtëpinë e Atit më 17 shkurt 2015, duke lënë pas vetes një histori, shumë



kujtime dhe botime, një jetë kushtuar Zotit, Kishës Katolike, Popullit Shqiptar, sidomos Arbëreshëve, shembull atdhedashurie nëpërmjet kulturës së jetës dhe qytetërimit të dashurisë.

Miqësia dhe vëllazëria, komunikimi ynë tashmë vazhdon edhe në amshim.

Atë Emanuele Giordano ishte një prift arbëresh - i mirë dhe i njohur, mjaft i dalluar dhe afirmuar, intelektual i dorës së parë, i afërt dhe shumë i dashur, njeri që la gjurma të pashlyeshme në kulturën arbëro-shqiptare, sidomos në lëmin e gjuhës dhe të liturgjisë. Zoti e shpërbleftë për shërbimin e madh flijues dhe dhurues, ndërsa kujtimi i tij lë të jetë ndër ne i gjallë dhe frymëzues për të gjithë, sidomos për breznitë e reja. Pushoftë në paqe!



Ndriçim Kulla
Tiranë

AT ZEF VALENTINI NË SHQIPËRI SI MISIONAR KULTUROR

At Giuseppe Zef Valentini në vitin 1979 në fundin e jetës, në klinikë me një vazo me lule në duar, të dhuruar nga shqiptarët, që i qëndruan deri në fund pranë, në shenjë mirënjohjeje për atë që ai ka bërë për kombin shqiptar

Pas një pune kaq titanike sa ajo e jezuitit at Valentini, edhe organizmi më i fuqishëm njerëzor do të ishte ezauruar. Më në fund natyra kërkoi të drejtat e saj. Në 1970, në moshën 70- vjeçare, at Valentini dha dorëheqjen nga detyra e tij si titullar në Universitetin e Palermos, por nuk u largua prej andej, se donte të qëndronte pranë universitetit ku vazhdoi të shkonte herë pas here për të dhënë leksione deri në 1975-n. Me rastin e 70-vjetorit të lindjes mori vlerësime të merituara për punën e tij titanike. Por jo nga Shqipëria, ku tanimë konsiderohej armik i betuar.

Ndoshta më të rëndësishmet për studimin tonë janë ato vlerësime që janë bërë nga albanologët e njohur, siç ishte rasti i historianit dhe albanologut Peter Bartl, i cili në një shkrim me titull “Mbi veprën historike të Giuseppe Valentinit”, botuar në revistën “Shejzat” në 1970-n, shkruante: “Duket

thujse e pamundur që të kesh parasysh plotësisht publikimet e panumërta të Xhuzeppe Valentinit, që kanë si objekt çështjet e historisë shqiptare, prandaj dua të zgjedh më të rëndësishmet, për t'i radhitur në katër fusha temash: 1) Burimet mbi historinë shqiptare; 2) E drejta zakonore e shqiptarëve; 3) Venediku dhe Shqipëria; Do të meritonte që të zhvillohej në një libër më vete ideja e jezuitit at Zef Valentini për ta shpjeguar mendësinë dhe shpirtin e shqiptarit, duke i parë njerëzit e shquar që ka nxjerrë kombi shqiptar si kurorëzim i këtij shpirti dhe mendësie, që i bënë ata të ndihen si bashkëthemelues të qytetërimit evropian. Vitet shtatëdhjetë janë vitet e shuarjes së ngadaltë të at Valentinit, vitet e muzgut të atit të albanologjisë moderne, nëse mund t'i quajmë kështu.

Megjithatë ai vazhdoi të punojë deri në ditën e fundit të jetës, siç e kam treguar në biografinë që kam shkruar për të. Në 1975 ai u largua përfundimisht nga Palermo dhe shkoi në Milano, ku u vendos në Kishën e Shën Fedeles. Vitet e Palermos, që nga 1952 deri në 1975, duhen llogaritur si vite shqiptare, për shkak se ai gjatë





kësaj kohe u mor kryesisht me studime albanologjike. Palermoja u bë Shqipëria e at Valentinit, në pamundësi për të shkuar në Shqipëri, siç do të kishte dashur. Kështu që, kur llogaritet koha e qëndrimit të at Zef Valentinit në Shqipëri, duhen llogaritur edhe vitet palermitane të tij. Një pjesë të madhe të viteve palermitane at Valentini i kaloi midis arbëreshëve të Italisë, pra në një copëz Shqipërie. Kështu që duhet thënë se e kaloi në Shqipëri pjesën më të madhe të periudhës nga viti 1922 në 1975. Midis këtyre viteve ai bëri veprën e tij të madhe, pjesa më e madhe e së cilës i përket albanologjisë në të gjitha fushat e saj. Por edhe në katër vjetët e fundit të jetës së tij at Valentini vazhdoi të mendonte dhe të punonte për tema shqiptare. Megjithatë që nga viti 1976 u detyrua të bëhej banor i përhershëm i një klinike. Tanimë e ndiente se po i afrohej vdekja.

Enologu shijehollë, edhe anëtari i Akademisë Italiane të Kuzhinës, nuk kishte më oreks për të ngrënë gjellët e shijshme që i përgatishnin motrat (murgeshat) që kujdeseshin për të. Njeriu që mund të fliste për kulinarinë njëlloj si për historiografinë, ai që mund të diskutonte për përgatitjen e një salce të sofistikuar, ashtu si për nuancat e latinishtes mesjetare, ai që shijonte me të njëjtën kënaqësi letërsinë e mirë dhe kuzhinën e mirë, ishte duke humbur shijen e tij të hollë. Për të kjo ishte shenja

më e sigurt se po i afronte vdekja. Por për të, pas muzgut të jetës nuk vinte nata e vdekjes, por dita e shkëlqyer e botës së përtejme, ku me jetën që kishte bërë në këtë botë, i kishte siguruar shpirtit jetën e pafundme të ndritur. Edhe ai i ishte lutur Zotit, ashtu siç thotë Nënë Tereza në poezinë e saj “Lutje e përditshme e misionarit të dashurisë”.

Kur at Valentini u nis si misionar në Shqipëri, në 1922-shin, ai iu lut Zotit që ta ndihmonte t'u shërbente atyre që ishin të varfër në kulturë, që kishin uri për kulturë, se një popull që ushqehet me kulturë të mirë nuk do të vuajë për bukë, se do të mësojë ta bëjë bukën. Njerëzit e ushqyer me kulturë të mirë do të bëheshin edhe ata misionarë apo, siç thotë Nënë Tereza, lajmëtarë të paqes së Zotit. Këta njerëz pastaj do të shpinin dashurinë atje ku sundonte urrejtja, do të shpinin pajtimin atje ku sundonte dhuna, do të shpinin bashkimin atje ku sundonte ndarja, do të shpinin të vërtetën atje ku

sundonte lajthitja, do të shpinin shpresën atje ku sundonte dyshimi, do të shpinin dritën atje ku sundonin hijet, do të shpinin gëzimin atje ku sundonte trishtimi. Këta njerëz të ushqyer me kulturë të mirë do të kërkonin të ngushëllonin të tjerët para se të ngushëlloheshin vetë, do të kërkonin të kuptonin të tjerët, para se të ankoheshin pse nuk kuptohen nga të tjerët, do t'i donin të tjerët, para se të kërkonin të duheshin prej tyre. Këta do të ishin njerëz që do të fitonin nga vetëmohimi.

Ku i kemi ne njerëz të tillë sot në Shqipëri? Nuk duhet të pretendojmë që t'i kemi, nëse nuk i kemi ushqyer me kulturë të mirë. Njeriu është si ajo bima që rritet sipas llojit të ujit me të cilin ujitet. Në qoftë se i hidhet ujë i ndotur, i përzier me helme toksike, bima do të rritet e sëmurë, do të thahet. Në qoftë se i hidhet ujë i pastër, ajo do të rritet e shëndetshme. Çfarë presim ne nga brezat e rinj kur nuk jemi në gjendje t'i ushqejmë me kulturë të mirë? Dhe nuk jemi në gjendje ta bëjmë këtë gjë, se nuk duam ta pranojmë se kulturë e mirë është kultura e llojit valentinian. Në fund të fundit ky ishte dhe qëllimi i at Valentinit kur ia dedikoi jetën e tij popullit shqiptar. T'u jepte brezave të rinj të shqiptarëve ushqim të mirë kulturor. Kështu ai shpresonte se vepra e tij do të shërbente si një manual për të bërë misionarë të rinj kulturorë dhe ai kështu do të shumëfishohej në ta. Çdo lexues i

Valentinin mund të bëhet një misionar kulturor si ai, që të shpërndajë ushqim të mirë kulturor në mjedisin ku jeton.

Në fund të fundit, çfarë është një misionar, përveçse një njeri i frymëzuar që mëton të përhapë fjalën e mirë? Ai që e lexon Valentinin, bëhet misionar si pa e kuptuar dhe kështu më ndodhi dhe mua. Prof. Attilio Vaccaro e përfundon kështu biografinë e tij të shkurtër për at Zef Valentinin: Që në fund të viteve '80, at Karmelo Kapici pat dëshiruar botimin, në mos të "Opera omnia" të Valentinin, çka do të ishte një ndërmarrje kolosale, pasi mjafton të sillen ndërmend vëllimet e "Akteve shqiptare-venete", të paktën të pjesës më të madhe të shkrimeve të tij, mbi të gjitha atyre shkrimeve minore ose të rralla e, për pasojë, të vështira për t'u konsultuar.


Shpresoj që këto pritshmëri fisnike mund të rrokten nga ndonjë studiues, i ri dhe vullnetfortë, për t'iu afruar gjeneratave të ardhshme një guidë të pasur për studimin, kërkimin dhe mësimdhënien e albanologjisë. A nuk kërkon këtu Attilio Vaccaro që një njeri në Shqipëri që do të njihej me veprën e at Valentinin, të frymëzohej sa për t'u bërë misionar kulturor, që të ndërmerre misionin e vështirë për të botuar dhe përhapur në Shqipëri veprën madhore të at Valentinin? Dikujt do t'i ndodhte një gjë e tillë dhe rasti e solli që të më ndodhte mua, madje do të ndihem vërtet i lumtur nëse edhe të tjerët do të mendonin kështu. Para një viti e gjysmë unë botova një biografi të plot për at Valentinin, që ishte dhe një paraqitje e mënyrës se si e njoha, si e kuptova unë atë nga leximi i veprës së tij, i kujtimeve të atyre që e kishin njohur etj. etj.

Në fund të fundit ky libër tregon se si dhe përse u bëra unë një misionar kulturor, ose siç më pëlqen mua të them një misionar valentinian. Kur vdiq at Valentinin, muzgun në të cilin jetoj vitet e fundit të jetës do ta linte në këtë botë, dhe ky muzg qëndron ende mbi emrin e tij në Shqipëri. Prandaj dhe këtë pjesë unë po e quaj "Muzgu i Atit të Albanologjisë", ky muzg i mbajtur qëllimisht rreth emrit të tij, duhet shpërndarë me dritën e veprës së tij. Dhe kjo është një dritë që jepet falas, ashtu si drita e diellit. E them këtë se kur njihesh me veprën e at Zef Valentinin nuk mund të mos bësh pyetjen se sa para do t'i ishin dashur shtetit shqiptar që të shpenzonte për këtë vepër, në qoftë se atë do ta kishin bërë studiues të paguar nga shteti, si akademikë, profesorë, punonjës të instituteve kërkimore shkencore shtetërore, të universiteteve.

Sa para për dieta (udhëtime, fjetje, ushqime etj., pa llogaritur rrogat dhe shpërblimet) duheshin

harxhuar për kërkuesit që do të dërgoheshin në qytetet e ndryshme të Evropës për të punuar në arkiva që të nxirreshin të gjitha dokumentet që ka nxjerrë at Valentinin dhe që përfshihen te "Akte shqiptare-veneciane", apo në shumë botime të tjera të tij? Sa do të ishin paguar ata studiues që do të punonin për të bërë ato studime për të drejtën zakonore, gjuhësinë etj? Se shteti paguan shumë studiues për të punuar në këto fusha, madje edhe për gradat e doktoraturat e tyre, të cilat i shoqërojnë ata deri në një pension të diferencuar. At Valentinin punoi pa asnjë shpërblim, si misionar për ne shqiptarët. Me veprën e at Valentinin ndodh i njëjti proces si me përfitimin e energjisë diellore.

Duhet harxhuar para për të bërë panele diellore. Edhe në rastin e veprës së at Valentinin duhet harxhuar para për ta botuar atë, për ta promovuar me kujdes atë dhe me siguri do ndihet ndikimi shkencor i saj. Këto do të jenë para të harxhuara nga shteti shqiptar shumë më mirë se në disa veprimtari apo koncerte të bujshme që bëhen veç për berihaje, e që vetëm me muzikën nuk kanë të bëjnë. Nuk e fsheh se edhe unë, si Valentinin, dikur kam pasur hezitimet e mia, ndonjëherë kam dashur edhe ta lë këtë punë, i lodhur nga pengesat e shumta që më dilnin. Por gjithmonë më vinte ndërmend ai moment në vitin 1932, kur Papa Piu XI e ndali at Valentinin në çastin që po dilte nga zyra e tij, i vendosur që të kërkonte ta transferonin nga misioni i "vështirë" shqiptar në një mision në një vend tjetër. Më ngjan sikur ata dy burra të shenjtë më vështrojnë në sy e më jepnin kurajë, që edhe unë, si at Valentinin, në atë kohë, të mos i ndahem punës së nisur për botimin e plot të gjithë korpusit të veprës së tij, por gjithashtu edhe njohjes së veprës shumëdimensionale që ai ka krijuar për vendin tonë.



Prof. Vinçenc Gjini
Kroaci

STUDIUES I SHQUAR I HISTORISË SHQIPTARE

Dr. Don Gaspër Gjini
(1930-1985)

“Dita të cilën njeriu ia kushton tjetrit nuk është kurrsesi humbje, por dobi. Ditët në të cilat nuk bëjmë asgjë për të tjerët, por vetëm për veten, janë ditë të humbura”.

Më 7.3.1985, pas një sëmundjeje të shkurtër, në moshën 55-vjeçare, vdiq në spitalin e Beogradit, Dr. Don Gaspër Gjini. Pra, u mbushën 30 vjet prej vdekjes së tij. Sikur ka jetuar dhe vepruar me përvujtëri e modesti, ashtu edhe na braktisi pa zhurmë e pa perceptuar. Kaloi nga kjo botë i rrethuar me dashuri të atyre për të cilët u kujdes deri në ditët e fundit. Ishte njeri me virtyte të larta njerëzore. Jetoj kohëshkurtër, kurse përmbushi shumë kohë. Jeta e tij ishte mision dhe la gjurmë të pashlyeshme.

Lindi në Ferizaj (24.9.1930), në një familje të madhe bujare me 12 fëmijë, prej prindërve, nënës Dushë dhe babait Kolë. Në moshën e vegjëlisë me vendosmëri, ndërgjeshmëri e sinqeritet të qëndrueshëm vendosi t'i kushtohet apostullatit, e të bëhet prift. U shkollua në Shkodër, në Pazin të Istrisë, ndërsa studimet teologjike i kreu në Gjakovo të Sllavonisë (30.6.1956). U shugurua më 2.7.1955. Studimet e mëtejshme i vazhdoi në Romë, ku, me sukses të jashtëzakonshëm, doktoroi të drejtën kanonike, në Universitetin e shquar Propaganda Fide në Urbaniana (1968), me temën *“De fontibus historico-juridicis ecclesiar Scopiensis”* (Mbi burimet historiko-juridike të kishës së Shkupit). Për sukses të lartë, si studenti më i mirë në Kolegjin ndërkombëtar Papnor të Vatikanit, Papa Pali VI e dekoroi me medalje të artë, dhe për ditën e Shën Pjetrit dhe Shën Palit, mbi varrin e tyre kremtoi Meshën e Shenjtë, së bashku me Papën. Doktoratën e mbrojti në gjuhën latine me sukses të lartë. Ishte doktoranti i parë shqiptar nga Kosova pas Luftës së Dytë Botërore.

Më vonë, temën e doktoratës e përpunoi dhe në formë të zgjeruar e botoi në tri gjuhë: kroatisht, shqip dhe anglisht. Kroatisht është me titull: *Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeća* - KS - Drita, Zagreb, 1986, diç më vonë në gjuhën shqipe: *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj* - Drita, Ferizaj, 1992, dhe më në fund në gjuhën angleze: *The Shkup-Prizren Diocese Through Centuries* - Drita, Prizren, 20000). Ky libër i jashtëzakonshëm do të jetë plotësim i mirëseardhur i bibliotekave të gjithë atyre që iu kanë kushtuar studimit të ilirëve të lashtë, qofshin shkencëtarë apo lexues të rëndomtë, të cilët dëshirojnë të pasurojnë dijeninë e tyre mbi Ilirët dhe historikun e shqiptareve në Kosovë. Ky libër ka rëndësi të posaçme për kishën tonë, pasi na njofton me

historikun dhe fenë tonë 2000-vjeçare.

Don Gaspri e përfundon librin me fjalët:

“Jetojmë me plot shpresa se ardhmëria do ta plotësojë krejt atë që na e kanë marrë shekujt. Le të na ndihmojë i Miri Zot që këto përpjekje fisnike të realizohen.

Shpresoj se ky libër do t'i shërbejë njohjes më të mirë të së kaluarës së largët dhe të afërt të katolikëve të këtyre anëve të cilët me shekuj kanë qëndruar si roje besnike të amanetit të shenjtë të Shën Palit”.

Po i përmend vetëm dy doktorë të shkencave, të cilët merren me këtë problematikë. Për librin thonë:

Prof. Dr. Jahja Drançolli: *“Kjo vepër ka peshë shumëdimensionale. Zotëri Gjini ka arritur të shfletonte shumë nga dokumentet me peshë historike të periudhës së Dardanisë antike si dhe të Mesjetës Shqiptare. Vepra e tij është bazë e pakalueshme për*

Ipeshkvia shkup prizren nëpër shekuj

GASPËR GJINI



studimet albanologjike” (Koha Ditore - 5.6.2005).

I njëjti autor thotë: “*Me monografinë e Dr. Don Gaspër Gjinit, të botuar në tri gjuhë, i pari zbuloi njoftime, të cilat s'i kishte dëgjuar albanologjia deri në atë kohë, si kode me anëshkrime, libra të rrallë, që sot ruhen vetëm në arkiva dhe biblioteka të njohura të Evropës. Kjo vepër mund të konsiderohet si udhërrëfyes për kërkimet tona të mëtejshme në këtë lëmi. Kam përshtypjen se edhe sot, ne s'mund të shkruajmë Historinë e Kosovës, nëse s'i marrim në konsideratë rezultatet bazike të kësaj vepre*”. (KOHA - për kulturë - 18.6.2005).

Prof. Dr. Edi Shukriu: “*Në kuadër të studimit të historisë së lashtë dhe në veçanti të historisë kishtare, mendoj se Dr. Don Gaspër Gjini ka dhënë një kontribut të çmuar duke i vënë bazat për studimin e historisë kishtare dhe të kishave tona, por puna e tij duhet vazhduar dhe thelluar*”.

I cituam këto thënie të eksperteve për krijuesin dhe hulumtuesin e palodhur Don Gasprin, për ta ekspozuar punën e tij të madhe dhe vlerat e kërkimeve të tija të mëdha, për të zbuluar fakte të reja për historinë e popullit tonë, qofshin kombëtare apo fetare, që paraqitin një kontribut jashtëzakonisht të madh dhe të vlefshëm.

Don Gaspri përpiloi dhe botoi, në dy botime, edhe librin e uratave “*Shujta shpirtërore*” (Drita, 1978 dhe 1986), në të cilin përfshiu: *Përditë me Zotin, Të vërtetat që duhet t'i dijë e t'i besojë secili katolik, Mesha e shenjtë, Sakramentet, Sakramentorët, Lutje të ndryshme, Këngë të devotshme, Shtojcë*.

Puna baritore

Don Gaspri ishte klerik, intelektual, poliglot, krijues dhe shkencëtar. Ishte i qëndrueshëm dhe i patundur edhe në kohët më të rënda. I shërbeu kishës e ungjillit. Ishte prift i popullit të Perëndisë, njeri i fjalës e i veprave. Kurrë nuk është larguar prej popullit. Kujdes të posaçëm atëror kishte për sëmure dhe nevojtarë. Ishte i singertë dhe bir besnik që ndiqte me përpikëri dogmat dhe kërkesat e fesë hyjnore. Në biseda prore ishte i gatshëm për këshilla e porosi, duke përcjellë fjalë të ëmbla e të ngrohta, fjalë shenjtërore. Edhe në marrëdhënie kolegjiale ishte gjithmonë i gatshëm të ndihmonte e të këshillonte për të mirën e tërë famullitarëve. Emri i tij mallëngjen të gjithë ata që e kanë njohur. Ndjenjë falënderimi e admirimi për gjithçka që palodhshëm bëri për kishën, popullin, shkencën dhe kulturën tonë shqiptare. Shpesh thoshte: “*Dita të cilën njeriu ia kushton tjetrit nuk është kurrësi humbje, por dobi. Ditët në të cilat nuk bëjmë asgjë për të tjerët, por vetëm për veten, janë ditë të humbura*”.

Në fillim ishte sekretar shumëvjeçar i ipeshkvit, e më vonë kancelar. Pas tërmetit në Shkup (1963), Selia

ipeshkvore u shpërngul përkohësisht dhe kaloi në Ferizaj, në Kishën e *Engjëllit të Rojës* (1963-1968). Së fundi, deri në vdekje, u rikthye në Shkup (1968-1985). Me kthimin e tij në Shkup, shumë vjet shërbeu në barakë, në Bitpazar (15 vjet), në Kishën e *Shën Jozefit*, ku edhe jetonte. Kushtet për jetesë ishin mjaft të rënda dhe jo të përshtatshme për një jetë normale. Qëndrimi shumëvjeçar në barakë la pasoja fatale për shëndetin e tij. Këtu shëndeti i tij filloi të shkatërrohej ngadalë.

Ai ishte iniciues për ndërtimin e Katedrales së *Zemrës së Krishtit* në Shkup. Pas inaugurimit të Katedrales (1982) Don Gasprin e emëruan famullitar të saj.

Në Shkup ishte nismëtar i mbajtjes së të gjitha riteve fetare në gjuhën shqipe. Këtë përtëritje famullia e Shkupit nuk e kishte përjetuar kah mot. Në jetë dhe veprimtari është djegur për popullin e vet. Deri në vdekje e predikonte fjalën e Zotit me zell të madh. Ai ishte famullitari i fundit në Kishën e Shkupit i cili predikoi në gjuhën shqipe.

Vite me radhë ishte kryetar i Gjyqit Kishtar Dioqezan, studiues i palodhshëm i të kaluarës sonë fetare e kombëtare, bashkëpunëtor i zellshëm i “Dritës” etj..

Përkushtimi i tij për të kultivuar vlerat kombëtare dhe për të mos lejuar që ato të humben nëpër kohë, bëri që ai të ishte hulumtues i pareshtur i të gjitha bibliotekave nëpër qendrat botërore, që nga vendi, Vatikani, Vjena, Parisi e deri tek Amerika, të cilat mbajnë nën dry pjesë të historisë sonë. Këtë hulumtim ia mundësoi njohja e shumë gjuhëve të huaja.

Posaçëm duhet të ceket nderimi i tij ndaj Nënë Terezës. Si kancelar shumëvjeçar i Ipeshkvisë Shkup-Prizren, e përcillte sipas protokollit në të gjitha vizitat që i bënte në Shkup apo në Kosovë. Edhe në fund të vizitave Don Gaspri e përcillte në aeroport të Shkupit. Pranë ndarjes së çmimit *Nobel* Nënës Terezës, në Oslo të Norvegjisë (1979), bashkë me Don Lush Gjergjin, do të ishte i pranishëm dhe Don Gaspri.

Pjesën më të madhe të jetës si meshtar, ai ia kushtoi veprimtarisë baritore dhe studimeve. Toka kosovare rriti një prift atdhetar dhe e mban në gjirin e saj, e neve na takon ta falënderojmë Zotin dhe ta kujtojmë me nderim.

Virtytet

Jetën e Don Gasprit e stolisi modestia dhe përvujtëria. Gjithnjë iu është mbajtur parimeve jetësore. Shumëkujt i ka ndihmuar me fuqinë e fjalëve, të besimit, shpresës ose ngushëllimit. Besimtarë apo jo, ata të cilit e kanë njohur Don Gasprin, e kanë çmuar si shembull modestie, përkushtimi dhe virtyti.

Është mbajtur me sëmundje të rëndë. Asnjëherë

nuk është ankuar. Në mënyrë të shquar, duroi stoikisht çdo gjë. Edhe në momentin kur i erdhi vdekja, ishte plotësisht i qetë. E bëri vdekjen si të lindë. I kredhur dhe i përgatitur iu lëshua Zotit. Fjeti gjumin e vdekjes dhe i ra kambana e vdekjes. Ra në gjumë të përhershëm... Është dukur i mëshirshëm, sikur të jetë i lumtur që po shkon para fytyrës së Zotit. Ai tani shikon Zotin, ndaj edhe ne jemi të lumtur që e kemi pajtor në qiell.

Humbja e rëndë, nga njëra anë e të gjithave, na bën të pikëlluar e të varfër, e nga ana tjetër tejte krenarë. Ka qenë i vetëm, i madh dhe i papërsëritshëm. Kurrë nuk e shikoi veten, por gjithnjë është kujdesuar për grigjën e vet.

Sëmundja

Përrjetoi dy operacione, në Shkup dhe në Lubjanë. Pasi nuk e ndjeu vetën mirë pas operacionit të parë, vendosëm ta transportojmë në Lubjanë. Gjatë periudhës së sëmundjes tërë familja ishte pranë tij. Për mjekimin e tij njëmuor në Lubjanë, ne, të familjes, ishim të ndarë në dy ndërrime. Në turnin e parë ishte vëllai, i ndjeri Gjergji dhe dhëndëri Nikë Dishpalli, e në të dytin motra Maria dhe unë. Prej Lubjanës kaluam në Beograd te motra Karolina, ku u shfaqën simptomat e rrejshme të përmirësimit shëndetësor. Mirëpo, kjo situatë ishte e shkurtër dhe e dërguam në spital, ku kishte një trajtim dhe respektim të posaçëm, sidomos nga ana e personelit. Edhe këtu e vizitonin shumë miq e dashamirë, si edhe ipeshkvi i Beogradit, Alojzij Turk me priftërinj. Në momentin e fundit të jetës së tij motrat Karolina e Jozefina dhe unë ishim me të, të ndenjur pranë tij, gjithnjë së bashku, duke u lutur. Edhe çastet e pushimit i kalonte në lutje.

Në spitalet e përmendura personeli mjekësor ishte i befasuar pa masë me inteligjencën, qytetërimin dhe kulturën e tij, duke bërë pyetje se kush është ky njeri dhe çka është? Përgjigjja e tij, në gjuhën sllovene ishte: *"Jam prift shqiptar nga Kosova..."*.

Kudo është respektuar me nderim të veçantë. Në spital e vizituan shumëkush të njohur, ndër të cilin ishin edhe nunci papnor dhe arqipeshkvi i Sllovenisë Imzot Alojzij Shushtar. Këto vizita i ngjallnin emocione të fuqishme e të thella, duke komentuar: *"Kush jam unë që t'më bëjë vizitë nunci dhe arqipeshkvi?!"*

Ndonëse ishte i sëmurë, prore na drejtonte me sy



buzëqeshjeje mëshiruese që edhe sot na përshkon. Ishte i qetë e i heshtur. Me vdekjen e tij vdiq edhe një pjesë e jona. Pavarësisht sëmundjes së rëndë, jetoi për të tjerë dhe shkoi në vend më të mirë.

Vdekja e parakohshme, na la në pikëllim të madh. Një proverb thotë: *"Ai që mbahet mend nuk vdes kurrë!"*

Në kujtesë të thellë më ka mbetur vizita e katër kolegëve - priftërinjve kosovarë, në spitalin e Beogradit, kur të gjithë ia puthën dorën Don Gaspriti, u gjunjëzuan dhe iu lutën Zotit. Me qetësi, iu drejtua kolegëve, duke u lënë amanet: *"Vëllezër, po ju lutem, të keni kujdes për shëndetin tuaj. Kurrësi mos pritni, në asnjë moment, të bëhet vonë. Mbani mend këtë porosi!"* Në ceremoninë e rastit, përveç të tjerave, Dr. Don Lush Gjergji tha për Don Gaspriti: *"Humbja e tij për ne është e madhe, e rëndë, pikëlluese, e pazëvendësueshme"*.

Jeta dhe vepra e tij janë përmendore të gjalla shpirtërore e fetaro-kulturore, për ne dhe më gjerë, për popullin tonë shqiptar. Ai i pari e dha një paraqitje panoramike të historisë së krishterimit në popullin shqiptar, prej kohës apostolike e deri në ditë tona. Kjo pasqyrë e së kaluarës sonë, e përgjakshme dhe e lavdishme, pa dyshim do të jetë dritë dhe rrugë për një ardhmëri më të mirë.

Në oborrin e kishës, në Ferizaj, qëndron përmendorja e tij, e cila përjetëson kujtimin e njeriut të shquar që kujtohet brez pas brezi. "Qoftë i amshuar

Iliriana Koleka
Tiranë

KONGRESI I PARË I MANASTIRIT (14-22 NËNTOR 1908)
(Pjesa e parë)

Kongresi i parë i Manastirit (apo Kongresi i Alfabetit) është tubimi i dijetarëve shqiptarë më 14 - 22 nëntor 1908, në Manastir, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Gjatë zhvillimit të letërsisë shqipe ishin hartuar disa alfabetë të ndryshme. Një nga më të fundit ishte ai i krijuar në Stamboll dhe quhej Alfabeti i Stambollit. Mendimi zotërues ishte se shkronjat jo latine nuk ishin të përshtatshme për mbarësinë e shqipes e bashkimit gjuhësor kombëtar. Për këtë arsye, shoqëria më aktive dhe e mirënjohur "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte fillimi i letërsisë mbarë shqiptare. Prandaj, më 14 nëntor 1908, në Manastir u mbledh Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit.

Pjesëmarrësit

Në kongres ishin të pranishëm 160 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Mit'hat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: Liria dhe Dituria. Sekretare e

komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë. Nënkyetar u zgjodh Grigor Cilka, nga Korça si dhe 11 anëtarë të tjerë. Në atë Kongres merrnin pjesë shqiptarë të fesë myslimane, katolike, ortodokse, dhe protestante, njerëz të ditur dhe të gjithë erdhën së bashku, për arritjen e një qëllimi të madh kombëtar.

Historia e Kongresit

Kumtesa e mbajtur nga prifti katolik Gjergj Fishta, nga Shkodra, preku të gjithë pjesëmarrësit, sa një hoxhë rendi ta përqafonte para të gjithëve. Kërkesa e kombëtaristëve shqiptarë ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me alfabetin latin, gjë që do nënkuptonte mosnënshtrim, qoftë ndaj otomanëve, qoftë ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lërë mënjane alfabetin e Stambollit, dhe ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me alfabetin latin me 36 shkronja, i cili përdoret deri më ditët tona. Gjithashtu, u vendos që pas dy vjetësh të mbahej një Kongres i



dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrirjen e dialekteve gegë dhe toskë në një gjuhë të njësuar shqipe. Duke qenë se para Kongresit të Manastirit, gjuha shqipe ishte shkruar me shkronja arabe, greke, sllave, apo përshtatjet e tyre, vendosmëria e delegatëve për t'i kthyer sytë nga perëndimi ishte haptazi një shpallje kulturore e pavarësisë, gjë që nuk kaloi pa u vënë re as nga qeveria turke e as nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë.

Dom Ndre Mjeda, i thuri vargjet, ndoshta më të bukura gjuhës shqipe në atë kohë:

Përmbi zâ, që lëshon bylbyli,
Gjuha shqipe m'shungullon,
Përmbi erë, qi nep zymbÿli,
pa 'da zemrën ma ngushëllon.
Gegë e toskë, malësi, jallia,
jan një komb, m'u 'da s'duron,
fundë e majë një âsht' Shqipnia,
e një gjuhë t'gjith na bashkon.

Në Manastir u hap edhe shtypshkronja, e cila finançohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë punishte ishin të punësuar 17 vetë, të cilët punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme Bashkimi i Kombit si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore.

Ndërkohë çështja e gjuhës shqipe shpesh bëhej shkas për shpërthimin e dhunës së fanatikëve që sulmonin pa mëshirë përparimin e gjuhës shqipe. Babë Dudë Karbunara (1842-1917) i lindur në Berat, bashkëpunonte ngushtë me Kostandin Kristoforidhin. Babë Karbunara shumë herë filloi gjatë krenimit të meshës të lexonte ungjillin në gjuhën shqipe dhe kështu i filluan kërcënimet e para nga eprorët klerikë ortodoksë dhe, më 1895, fanatikët i dogjën të tërë shtëpinë. Prifti ortodoks kapedan Stathi Melani vraponte me librat shqip në gjë dhe me pushkën në krah fshat më fshat në Shqipërinë e jugut për përhapjen e shkollës shqipe dhe kishës shqiptare. Veprimtaria e Atë Stath Melanit ra në sy të autoriteteve turke. Tri herë turku ia dogji shtëpinë dhe librat shqip, por Atë Melani nuk pyeti. Më 24 Dhjetor 1917 Atë Stathi i kishin zënë pritë banda e kusarëve të Josif Suropullos, të cilët e vranë duke i prerë kokën.

Petro Nini Luarasi (1865-1911) është një nga atdhetarët e shquar që punoi për përhapjen e gjuhës shqipe në rrethin e Korçës. Qe drejtor i shkollës së djemve në Korçë. Petro Nini Luarasi shkante nga fshati në fshat për përhapjen e gjuhës shqipe. Më 20

shtator 1892, peshkopi i Kosturit Fillateri nxori një lajmërim me titull "Mallkimi i shkronjave shqipe". Më 1909, qeveria turke mbylli të gjitha shkollat shqipe dhe dha urdhër të prerë të shuheshin në zjarr të gjitha librat, dokumentet dhe letërsia shqipe. Gjendja politike në vend në atë kohë ishte kritike për të marrë flakë nga çasti në çast. Për atdhetarët shqiptarë dukej se nuk do t'i realizonin dot kurrë qëllimet e tyre të larta pa hapur më parë shkollat shqipe për formimin e rinisë. Deri në atë kohë rinia shqiptare kishte qenë objekt i propagandës së huaj në shkollat e hapura nga qeveria turke dhe nga kisha greke. Megjithatë, gjatë punës për krijimin e sistemit të tyre shkollor, atdhetarët shqiptarë u ndeshën me tri probleme të mëdha, pengesa nga autoritetet turke dhe greke, mungesa e të hollave dhe mungesa e mësuesve të shkolluar.

Shuma të vogla, por të dobishme të hollash, ishin mbledhur aty-këtu brenda vendit, kurse ato më të mëdha kishin ardhur nga shoqëritë dhe klubet shqiptare në vendet e tjera. Mirëpo kishte fare pak mësues të shkolluar të gjuhës shqipe. Për t'i bërë ballë kësaj sfide arsimore, Klubi i Selanikut thirri Kongresin e Elbasanit, nga data 20 deri 27 gusht të 1909. Në këtë Kongres tetëditor, që kishte synim zhvillimin e lëvizjes arsimore anëmbanë vendit, erdhën delegatë nga 28 shoqëri e klube shqiptare. Në Kongres u vendos që të themelohet "Shkolla Normale në Elbasan", një shkollë gjashtëvjeçare për përgatitjen e mësuesve të rinj. Njerëz të mësuar në Universitetet e huaja Evropiane u gjetën dhe u caktuan për të formuar trupin pedagogjik.

Klubi i Manastirit u caktua si qendra për krijimin e një Federate të Klubeve Shqiptare në Shqipëri dhe në kurbet. Qëllimi i Klubeve ishte përhapja e gjuhës dhe arsimit shqip, pa u përzier me politikë. Klubi korçar "Përparimi" u caktua si qendra financiare, që do të administronte ndihmat dhe shtimin e shkollave të ditës dhe të natës. Përgjegjësia kryesore dhe preokupimi i madh ishte mbajtja e Shkollës Normale të Elbasanit. Kongresi i Elbasanit nxiti të gjithë shqiptarët të futnin gjuhën shqipe në shkollat e huaja, të përhapura anëmbanë Shqipërisë. Më 18 nëntor 1909 u bë thirrja haptazi, "Për mbajtjen e Shkollës Normale të Elbasanit duhen, para, para e më shumë para". Nuk është e vështirë të përfytyrohet niveli i ulët i jetesës së njerëzve, që u bëhej një propozim i tillë! Mirëpo, me ose pa mjetet e përshtatshme, Shkolla Normale e Elbasanit vazhdoi të përgatiste pionierët e arsimit për Shqipërinë që po rilindte. Drejtori i parë i Normales ishte Luigj Gurakuqi. Vite më vonë kjo shkollë u pagëzua me emrin e tij. Shkolla Normale u hap në dhjetor të 1909, me 143 nxënës. Shpërthimi i shqiptarizmit i kaloi të gjitha parashikimet e armiqve të gjuhës shqipe. Në atë kohë dolën në dritë rreth 90 gazeta dhe revista shqipe, që

botoheshin në Shqipëri dhe në kolonitë shqiptare jashtë vendit. Xhonturqit, me kryetarin e tyre Ferit pashën, të frikësuar nga ky shpërthim i shpejtë i arsimit shqip, reaguesh, duke ndaluar shoqëritë, shkollat dhe botimet në shqip. Në Vlorë atdhetarët e ndershmë arrestoheshin dhe internoheshin, shkolla e Vlorës u mbyll, kurse drejtori i saj, Loni Naçi, u largua nga Shqipëria, nga frika e vrasjes. Në Gjirokastrë pionieri i arsimit shqip kombëtar, Koto Hoxhi, u internua në kështjellën e Bosforit. Pandeli Sotiri, themelues i së parës shkollë shqipe në Korçë, u internua në Selanik. Xhonturqit i kishin vënë detyrë vetes për të rrjepur të gjallë të gjithë shqiptarët e ndershmë që punonin për përhapjen e gjuhës shqipe. Gjërat po shkonin keq e më keq.

Dalja në pah e gjuhës shqipe, me shkronja latine, provokoi myslimanët injorantë e konservatorë. Ata protestuan se shqipja, ashtu si turqishtja, duheshin shkruar vetëm me shkronja arabe dhe se preferenca e atdhetarëve shqiptarë për shkronja latine perëndimore ishte një përçmim për fenë myslimane. Njerëz të paditur dhe injorantë formuan me mbështetjen edhe të Qeverisë së Xhonturqve në Stamboll shoqërinë “Mahfeli” me synim përçarjen e shqiptarëve dhe frenimin e arsimit në shqip. Në fund të vitit 1909, Qeveria turke ndaloi përdorimin e gjuhës shqipe me shkronja kombëtare, në të gjitha shkollat anembanë vendit. Gjithashtu, nxori një dekret, sipas të cilit, gjuha shqipe do të shkruhej vetëm me shkronja arabe. Me mbështetjen e qeverisë turke, Shoqëria reaksionare “Mahfeti” shtypi dhe shpërndau abetaret e para me germa arabe. Për këtë arsye, në shkurt të 1910, u mbajt në Elbasan një miting proteste, ku 7000 protestues ngritën zërin kundër përdorimit të shkronjave arabe për gjuhën shqipe. Po atë muaj protestat vazhduan në Korçë, Berat, ku mbi 15.000 vetë dogjën në qendër të qytetit abetaret shqiptare me germa arabe, të dërguara nga Stambolli.

Telegrame të shumta nga shoqëritë shqiptare të Selanikut, Shkupit e Manastirit u shprehën në mbrojtje të alfabetit shqip. Në Shkodër, një grup myslimanësh u bënë gati të organizonin një manifestim në përkrahje të shkronjave arabe. Mirëpo ndërruan mendje kur 60000 katolikë dhe myslimanë të ndershmë shqiptarë, nga Malësia e Madhe, organizuan ditë më parë një manifestim madhështor në përkrahje të shkronjave latine. Protesta të ngjashme u organizuan në Përmet, Kolonjë, Tepelenë, Frashër, Konicë etj.. Por turqit nuk deshën t’ia dinin. Atëherë në mars të 1910 u thirr Kongresi i dytë i Manastirit. Aty u vendos që të vazhdojë përdorimi i alfabetit kombëtar me

shkronja latine dhe protestat kundër vendimit të padrejtë të Qeverisë Turke.

Gazeta atdhetare “Shkreptima” e Kajros botoi një memorandum të hartuar nga kryengritësit që luftonin në malet e Shqipërisë. Në të theksohej se qëllimi i tyre nuk ishte për të plaçkitur apo për të vlarë, por për të luftuar për “lirinë e edukimit në gjuhën shqipe dhe me alfabetin kombëtar, lirinë për të hapur të gjitha shkollat shqipe të mbyllura nga qeveria turke dhe vënien në punë të shtypshkronjave, si dhe botimin e gazetave të ndaluara, lirinë e të burgosurve politikë. Dhe përfundonte me mesazhin: “E gjithë bota e qytetëruar dhe veçanërisht qeveria e perandorisë Otomane le ta dijë mirë se të gjithë shqiptarët, gegë e toskë, të krishterë e myslimanë, nuk do ta pushojnë luftën për këto tri kërkesa, derisa qeveria të na i garantojë ato me siguri”.

Edhe në këtë luftë, shkolla shqipe doli fitimtare. Me pak mjete dhe mësues, por me dëshirën në shpirt për dituri shkollore shqiptare, midis pengimeve, nga armiqtë e afërm dhe të largët, shkolla shqipe fitoi nga veriu e deri në jug të Shqipërisë dhe përgatiti breza të rinj atdhedashës. Megjithatë ky zhvillim kulturor ishte përfytyruar si jo i dhunshëm, shpejt ai u kthye në një zjarr të rrezikshëm. Shqiptarët trima si Isa Boletini dhe burri i zoti Ismail Bej Qemal Vlorë, do nxitonin hapat për të shpallur mëvetësinë e Shqipërisë më 28 nëntor të 1912 në Vlorë. Pas pak muajsh filloi Lufta Ballkanike dhe Manastiri e Shkupit, dy qytete historikisht të banuara nga shumica popullsi shqiptare, u pushtuan nga sllavët. Të gjitha dyqanet dhe librat shqip u dogjën dhe shumica e atdhetarëve shqiptar u therën nga serbët, disa u burgosën. Popullata myslimane shqiptare u detyrua të braktiste qytetin e Shkupit dhe të Manastirit, ato familje ortodokse shqiptare që mbetën aty, me kalimin e viteve dhe me dhunë u nënshtruan duke humbur dinjitetin e tyre shqiptar.



Arben LLALLA

KISHA ME EMRIN E NJË QYTETI DHE SHËN ALBANI

Për herë të parë emrin ALBAN na e tregon gjeografi i lashtë Klaud Ptolemeu, por faktet e fundit tregojnë se këtë emër e shohim përsëri jo në Iliri ose Arbëri, por shumë larg, në Britaninë e Madhe diku rreth viteve 300. (Ka shumë mendime që ngjarja të ketë ndodhur midis viteve 251-257, gjatë sundimit të Britanisë nga Decius ose Valeria, por ka një gojëdhënë se mundet edhe në vitin 209, kur Britania ishte nën pushtimin e perandorit Septimus). Fjalë është për Shenjtorin me emrin Alban (Shën Shqiptari), që u martirizua sepse ishte i krishterë dhe kjo nuk është gënjeshtë, as mashtrim, por një ngjarje e vërtetë historike që ka ndodhur në fillim të përhapjes së krishterimit, për martirin e parë të saj. Sot shumë kisha, manastire, organizata fetare e shkolla mbajnë emrin Shën Albani ose Albans. Emërtimi i këtyre lidhet me një ngjarje të ndodhur në Anglinë qendrore, dhe pikërisht në qytetin e quajtur dikur Verlamion, sot Saint Albans. (Qyteti Verlamion ishte themeluar nga një britanik me emrin Iton Age, pas pushtim romak të Britanisë në vitin 43, ky qytet u quajt Verulamium dhe u zgjerua shumë).

Nuk dihet saktë për familjen e shenjtorit Alban, por dihet se ai jetonte në shtëpi dhe jo kasolle skllave, pra i përkiste një familjeje ushtarake romake, sepse në disa raste figura e tij na tregohet me veshje ushtarake romake.

Ndoshta ndonjë familje romake e vendosur në këtë qytet duhet ta ketë pasur prejardhjen nga Albania (Shqipëria) dhe ka ruajtur emrin e vendit amë, por këto mbeten vetëm hipoteza. E rëndësishme është se kemi një shenjtor dhe një qytet me emrin ALBAN. Zanafilla e daljes në pah të emrit SHËN ALBAN fillon në fillim të viteve 200 ose 300.

Një ditë në shtëpinë e Albanit i cili ishte qytetar romak troket një prift i quajtur Amphibalus, të cilin e ndiqnin ushtarët romakë, sepse predikonte krishterimin. Ai e fsheh priftin për disa kohë në shtëpinë e tij. Gjatë qëndrimit prifti kryente lutjet fetare. Albani, duke parë përkushtimin e klerikut ndaj Zotit, i lutet priftit për ta pagëzuar në të krishterë pasi ishte pagan.

Ndjekësit e priftit mësojnë se ai fshihej në shtëpinë e Albanit dhe shkojnë për ta arrestuar. Para





se të vinin romakët për kontroll, Albani, për ta mbrojtur priftin, vesh rrobat e tij duke ofruar veten në duart e ushtarëve me rrezikun e dënimit me vdekje.

Ushtarët romakë e arrestojnë Albanin në vend të priftit të vërtetë dhe e dërgojnë para gjyqit. Gjatë gjykimit gjykatësi vërteton se i arrestuari nuk ishte prifti që kërkonin, por një njeri tjetër i cili ishte paraqitur si prift.

Gjykatësi e pyet Albanin se përse ka zgjedhur të fshehë një rebel? Për këtë shkak mund të dënohet me vdekje dhe nga cila familje vinte? – shenjtori ju përgjigj - Kjo çështje ju shqetëson juve!? Po ju them se jam i krishterë.

Atëherë gjykatësi këmbëngul për emrin e familjes që i përkiste. Albani i thotë se prindërit e thërrisnin ALBAN dhe i besojnë të vetmit Zot që ekziston, krijuesit të vërtetë që ka krijuar çdo gjë. Gjykatësi, pasi i dëgjoji këto fjalë dhe kuptoi se çdo torturë ishte e kotë që Albani të tërhiqej nga besimi i krishterë, e dënoi me prerjen e kokës. Kur mësoi Albani se ishte dënuar me vdekje, u gëzua dhe falënderoi Zotin sepse u ngeli besnik bindjeve të tij të krishterë.

Duke shkuar drejtë vendit të ekzekutimit Albani pa njerëzit e shumë që ishin mbledhur mbi urën që kalonte një lum dhe u afrua buzë lumit, ngriti sytë nga qielli dhe iu drejtua Zotit të plotfuqishëm që uji të zmbrapset duke lënë shtratin të thatë për të kaluar në anën tjetër. Kjo dëshirë e Albanit u plotësua nga Perëndia. Të pranishmit u habitën nga kjo mrekulli, bashkë me ta edhe ekzekutuesi, i cili e flaku shpatën tej dhe nxitoi për të Shën Albanin. Ai u lut që në vend

të njeriut të shenjtë, t'i prehej atij koka si martir.

Atëherë u gjet një ekzekutues i dytë i cili pasi ia preu kokën Albanit, vrau edhe ekzekutuesin i cili kishte refuzuar urdhrin e gjykatësit. Pasi kreu këto dy vrasje, ekzekutuesit i dolën sytë nga vendi.

Pas disa ditësh u kap prifti që kishte strehuar Shën Albanin, i cili po ashtu u ekzekutua.

Pas pak kohe gjykatësi dëgjoji për mrekullitë që kishin ndodhur nga lutjet e Shën Albanit dhe urdhëroi menjëherë ndërprerjen e përndjekjeve të njerëzve që besonin në Krisht dhe të

respektohej figura e tij.

Varri i Shën Albanit u kthye në vend të shenjtë, ku shumë njerëz të sëmurë, pasi faleshin, gjenin shërim të plotë. Atje ku dyshohet se u pre koka e Shën Albanin është ndërtuar Katedralja e St. Albans dhe brenda saj gjendet varri me disa pjesë nga trupi i tij. Ndërsa në faqet e kodrës u ndërtua pas shumë vitesh qyteti ST. ALBANS ABBEY, vetëm disa kilometra në veriperëndim të Londrës.

Sot ka me dhjetëra kisha katolike dhe ortodokse që mbajnë emrin Shën Alban në tërë botën. Figura e këtij martiri të parë të krishterimit në Britaninë e madhe respektohet. Dita kushtuar aktit të flijimit të tij është 22 qershori. Kjo datë fetare festohet në shumë vende perëndimori si Britani, Gjermani, Holandë, Danimarkë etj..

Nuk besoj se është rastësi që një martir i krishterimit në shek. I-II ka emër Shqiptari, pa pasur lidhje gjaku dhe gjuhe me Shqipërinë. Për fat të keq historia e Shën Albanit nuk njihet nga historiografia shqiptare.



Lazër Stani
Tiranë

SELIA APOSTOLIKE, MIKE E VJETËR E SHQIPTARËVE

Recension: Vatikani dhe Shqiptarët, Enti Botues Gjergj Fishta, Lezhë 2015.

Profesori i mirënjohur Sami Repishti, në tekstin "Shenjtëria Juaj: Mirësevini në trojet tona arbënore!", shkruar në prag të vizitës së Atit të Shenjtë në Tiranë, sjell një fakt shumë interesant:

Në fjalën përshëndetëse për shqiptarët gjatë vizitës së tyre në Vatikan, 28 prill 1968, 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, Papa Pali VI u shpreh kështu: "Bij fort të fort të dashtun shqiptarë!...në qoftë se historia ju ka pa të shtypun e të shpërndamë, mirësia e Zotit ka premtue që ju, me të gjithë perfaqësueset e 'gjakut tuej të shprishur' (Papa e tha shqip këtë frazë!) me veprimtarinë e gjallë që keni në shpirt, dhe me njohuri të fitueme, jeni ba urë miqësish e bashkëpunimi, dhe në këtë mënyrë, jeni ba paraardhësit e ekumenizmit modern". Dhe shtoi:

"Selia Apostolike gëzohet që ban pjesë me miqtë e vjetër të Atdheut tuej, mbasi e numëron veten njeni nga ata që kurr nuk u dolën fjalët".

Pikërisht këtë pohim të fundit të atit të shenjtë, sjell edhe libri, "Vatikani dhe shqiptarët", i botuar nga Senati Demokristian. Ky libër, që është produkt i konferencës shkencore "Vatikani dhe shqiptarët, nëpërmjet kumtesave të referuara nga historianët, intelektualët dhe shkrimtarët, që u bënë pjesë e kësaj konferencë dhe autorë të këtij libri, dëshmon pikërisht këtë fakt: Vatikani është miku dhe aleati i vjetër i shqiptarëve.

Është fakt i njohur se historia e Shqipërisë ngjan me një galeri pikturash të falsifikuara, ku kopja origjinale është tjetërsuar aq shumë, sa edhe me imagjinatën me të fuqishme e ke të vështirë ta përfytyrosh. Dhe një ndër kapitujt më të manipuluar të kësaj historie është ai i marrëdhënieve të shqiptarëve me Vatikanin. Manipulimi më i madh i fakteve, dokumenteve dhe dëshmime historike të marrëdhënieve të shqiptarëve me Vatikanin është bërë nga historiografia komuniste për arsye të pastra ideologjike.

Regjimi diktatorial stalinist e konsideronte Vatikanin si qendrën e reaksionit botëror dhe vetë komuniteti katolik një kontingjent i vazhduar "armiqsh". Për të argumentuar këtë historianët e oborrit shkruan pseudo historinë, duke e paraqitur Vatikanin si armik të shqiptarëve, si sabotues të përpjekjeve të tyre për liri dhe pavarësi, si bartës të

regresit dhe të errësirës shekullore.

Një faktor i dytë, por jo pak i rëndësishëm, në falsifikimin dhe manipulimin e këtyre marrëdhënieve, është otomanizmi, i pranishëm edhe sot e kësaj dite në variantin neo-otomanist me jo pak ndikim tek një numër historianësh dhe studiuesish. Të dy këta faktorë, të ndërthurur e në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë ndikuar që edhe në këto vite të tranzicionit politik, kërkimet historike të mbetën të keqorientuara dhe e vërteta historike të mbetët e pjesërisht e zbardhur.

Aleanca e komunistëve me neo-otomanistët (të dy grupet bashkohen dhe bashkëpunojnë në anti-europianizmin e tyre) vazhdon të ketë ndikim të ndjeshëm në historiografi, duke ricikluar pareshtur procesin manipulues të historisë. Ky manipulim qëndron pikësisht në mosnjohjen dhe mospranimin e rolit që ka luajtur komuniteti katolik në historinë e krijimit të kombit shqiptar dhe, së dyti, në anashkalimin e marrëdhënieve që ky komunitet dhe shqiptarët në tërësi kanë pasur me Selinë e Shenjtë përgjatë shekujve.

Askush, përveç historiografisë tonë të ideologjizuar, nuk e vë në dyshim faktin se katolikët shqiptarë, pavarësisht se janë të pakët në numër, siç shkruan shkrimtari i mirënjohur Ismail Kadare, përfaqësojnë fenë e parë të shqiptarëve. Ata, vazhdon Ismail Kadare, kanë një zbritje vertikale në historinë dhe kulturën shqiptare të pashembullt. Ata i kanë dhënë kombit shqiptar simbole dhe shenja themelore nga Gjergj Kastrioti te Nënë Tereza.

Ata janë ura më e vjetër dhe asnjëherë e shembur që lidh Shqipërinë me Evropën. Është kjo arsyeja, që antieuropianistët dhe gjithë dashakëqijtë që tmerrohen nga një komb dhe një Shqipëri evropiane, kanë vënë në shënjestër emblemat e kombit shqiptar si Gjergj Kastrioti dhe Nënë Tereza, madje shkohet deri atje sa mohohet pushtimi Osman dhe fjala pushtim përpiket të zëvendësohet me fjalën bashkëjetesë.

Sidoqoftë, asnjë manipulim dhe asnjë term i komprometuar nuk mund ta tjetërsojë faktin tragjik të pushtimit, terrorin dhe masakrat që u kryen mbi shqiptarët gjatë pushtimit osman, dhunën e vazhdueshme, ndalimin e shkrimit të gjuhës shqipe, strategjinë asgjësuese të ndjekur ndaj shqiptarëve nga mesjeta deri në fillimet e shekullit të njëzetë.

Fakti që shqiptarët mbijetuan në Ballkanin me histori tragjike, pas atij terrori asgjësues dhe pushtimit

që zgjati jo me vite, por me shekuj, në vështirim të parë ngjan si një çudi e historisë, si një absurd që nuk mund të argumentohet nëpërmjet faktografisë historike. Megjithatë, sikurse shkruan Ernesto Sabato “në politikë rastësi nuk ka”.

E vërteta është se kjo mbijetesë nuk ishte “një rast fatlum i historisë”, se kjo mbijetesë u sigurua së pari nga rezistenca e vetë shqiptarëve, por edhe nga mbështetja e vazhdueshme e Vatikanit për këtë komb martirësh, që i kishte dhënë krishterimit dhe Evropës figura të shquara të historisë dhe identitetit të saj.

Kjo mbështetje ka qenë faktor vendimtar në mbijetesën tonë, në momentet më të vështira të historisë. Këtë e dëshmojnë të gjitha faktet e sjella në konferencë, fakte që historiografia komuniste i ka manipuluar dhe keqinterpretuar. Shqiptarët duke qenë një popull me krishterim të hershëm apostolik, kishin lidhje të konsoliduar me Selinë e shenjtë, lidhje që u faktorizuan sidomos gjatë qëndresës anti-osmane të Gjergj Kastriotit në një nga momentet më të vështira të historisë së qytetërimit evropian dhe të krishterimit. Gjergj Kastrioti - Skënderbeu gjeti tek Selia e Shenjtë aleatin dhe partnerin e tij më të besuar, përkrahjen e pakursyer dhe solidaritetin e përhershëm në përpjekjet e tij për të frenuar dhe kthyer mbrapsht ushtritë pushtuese më të fuqishme të kohës.

Kjo aleancë midis Vatikanit dhe shqiptarëve nuk u dobësua as në vitet e pushtimit osman, përkundrazi ka qenë vendimtare në mbijetesën dhe rilindjen e kombit shqiptar. Shkrimi i gjuhës shqipe, shkollat e para shqipe dhe Kuvendi i Arbrit, që shënon fillimin e procesit të Rilindjes Kombëtare me protagonist klerin katolik shqiptar, është bërë me mbështetjen e vazhdueshme të Selisë së Shenjtë, Vatikanit.

Pikërisht për këtë, në Konferencën Shkencore “Vatikani dhe Shqiptarët”, ne bëmë një përpjekje për të sjellë në vëmendje të publikut kontributin e Vatikanit në mbijetesën e Shqiptarëve dhe kontributin e klerit dhe të komunitetit katolik në kulturën, arsimin shqip dhe në Rilindjen Kombëtare që i sollën shqiptarët në momentin më të rëndësishëm të historisë së tyre, Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar me 28 nëntor 1912.

Unë dua të falënderoj sot historianët, Gjon Keka, Dorian Koçi, Katriot Marku, Nikollë Loka, Azem Qazimi dhe Thanas Gjika për punën e tyre serioze shkencore në përgatitjen e kumtesave për konferencë dhe që janë përfshirë si autorë në këtë libër.

Gjithashtu falënderoj në mënyrë të veçantë, poetin Visari Ziti për esenë “Nënë Tereza dhe Shqiptarët”, një sprovë bindëse dhe dinjitoze e Shenjtërisë dhe madhësisë së Nënës Terezë, ndërgjegjes së njerëzimit siç e kanë quajtur studiuesit.

Falënderoj gjithashtu, studiuesin dhe kritikun Agron Gjekemarkaj për esenë “Kodet kulturore në veprën e At Zef Pëllumbit, kësaj embleme të vlerave


tona shpirtërore e kombëtare, që sfiduan tmerrin, terrorin dhe ideologjinë e diktaturës, sistemin e antivlerave që u përpoq të instalojë.

Ndërsa eseja tjetër, shkruar nga poeti Ndue Ukaj, “Selia e shenjtë, pararojë e kombit shqiptar”, trajton përmbledhtazi, marrëdhëniet e Shqiptarëve me Vatikanin dhe analizon pozicionin pararojë të Vatikanit në mbrojtjen e çështjes shqiptare në momentet më të vështirë të historisë së tyre.

Në këtë botim, përveç kumtesave të referuara në konferencë nga historianët, studiuesit dhe shkrimtarët, janë përfshirë një studim i Akademikut Neritan Ceka “Shqiptarët dhe krishterimi i hershëm” si dhe mesazhet e Atit të Shenjtë dhe Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani me rastin e vizitës së Papa Françeskut në Tiranë.

Duke e mbyllur, dua të shtoj se Libri “Vatikani dhe shqiptarët”, në tërësinë e vet, është një dëshmi e lidhjeve të hershme midis Selisë së Shenjtë dhe shqiptarëve, por njëkohësisht edhe një dëshmi e identitetit tonë të patjetërsueshëm shqiptar dhe perëndimor, e të vërtetave tona historike, shkencore dhe kulturore, që na rendisin denjësisht në familjen e popujve të qytetëruar evropianë.

**Fjala e presidentit të Senatit Demokristian, mbajtur në promovimin e librit “Vatikani dhe shqiptarët”.*



Vizitë historike: Presidenti Nishani në Kryedioqezën e Tivarit (24 Mars 2015)

Presidentit i Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani, së bashku me një delegacion të zgjeruar, më 24 mars 2015, bëri një vizitë tejet të rëndësishme në Kryedioqezën e Tivarit, ku u prit nga Imzot Zef Gashi.

Pas vdekje së Karlo Poten, si kryeipeshkëv i Tivarit dhe Shkodrës në vitin 1886, Kryedioqeza e Tivarit kishte marrë tatëpjetën duke iu nënshtruar vazhdimisht presionit të bërë nga besimi sllavo-ortokoks dhe politika sllave e cila shfrytëzonte situatën politike për asimilimin e shqiptarëve. Politika malazeze dhe ajo serbe, gjithnjë e kanë mbajtur këtë Kryedioqezë si sllave, madje edhe sot qarqet e caktuara e trajtojnë në po të njëjtën mënyrë. Kryedioqeza e Tivarit në histori ishte pararendëse e popullit tonë dhe e kufijve që mbeten të pashlyer në zemrat e shqiptarëve andej dhe këndeje kufirit. Duhet përkujtuar se, në selinë e kësaj Kryedioqeze kanë vepruar me dhjetëra kryebarinj iliro-shqiptarë dhe shqiptarë njohura të mesjetës si: Pjetër Massreku (1624-1634), Pjetër Bogdani (1956-1670), Lazër Vlladanji (1749-1786), Gjergj Junku (1786-1787), Gjergj Radovani (1786-1790), Vinçenc Zmajeviq (1701- 1922), Karlo Poten (1855- 1886) etj.

Nga personalitetet të cilët kanë mbetur thellë në kujtesën historike, janë: V. Zmajeviq, organizuesi i Kuvendit të Arbrit në Melqi të Lezhës, në vitin 1703, si dhe C. Pooten, i cili me ngritjen e Shkodrës në rangun e Kryedioqezës, në vitin 1867, bëri që Shqipëria të pranohet shtet i pavarur në vitin 1912. Krahas pretendimeve sllave, Kryeipeshkvia e Tivarit mbetet në historinë tonë, një fanar shumë i rëndësishëm shqiptar në rrokopujën e egër ballkanike. Ishte kjo vizita e parë zyrtare nga një burrë shteti shqiptar, pas Kongresit famëkeq të Berlinit të vitit 1878, prandaj e meriton të quhet vizitë historike.






Dom Nikë Ukgjini


NDRE MJEDA
QENDRA MUZEORE

Botimet Fishta,
Lezhë, 2015



FJALA HYJNORE

Prishtinë - Shkodër 2014



MARCIN CZERMIŃSKI

SHQIPËRIA

Onufri
Tiranë 2014

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë